



Raporti Vjetor 2024



ANALIZA VJETORE E
VEPRIMTARISË SË GJYKATËS SË
APELIT TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM
PËR VITIN 2024



GJYKATA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

RAPORTI VJETOR 2024

ANALIZA VJETORE E
VEPRIMTARISË SË GJYKATËS SË
APELIT TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM
PËR VITIN 2024

Tabela e Përmbajtjes

HYRJE	3
ORGANIZIMI I TRUPËS GJYQËSORE	8
NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR	11
BURIMET NJERËZORE	13
VEPRIMTARIA GJYQËSORE NË SHIFRA	15
Treguesit e Ngarkesës	15
Çështjet e reja të regjistruara	15
Çështjet e shqyrtuara	18
Çështjet në pritje për gjykim	22
Treguesit e Eficiencës	28
Norma e Likuidimit të çështjeve	28
Koha deri në zgjidhjen e një çështjeje (ditë)	32
Mosha e çështjeve në pritje	34
Kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara	37
Treguesit e ngarkesës për gjyqtar	40
Volumi i punës për gjyqtar	40
Treguesi NR - Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar	2
Treguesi NR - Norma e Rendimentit për Gjyqtar	2
Tregues të tjerë	3
ZBATIMI I STRATEGJISË PËR ULJEN E NUMRIT TË ÇËSHTJEVE TË PRAPAMBETURA ..	19
MENAXHIMI ADMINISTRATIV I GJYKATËS	25
Mbledhja e përgjithshme e Gjyqtarëve	25
Këshilli i Gjykatës	25
Kancelari	26
Kryesekretaria	26
Shërbimi i arkivit	26
Statistikat	27
Sektori i Protokollit, Arkivës dhe i Koordinimit të Zyrave të Shërbimit	28
Zyrat e Shërbimit	29

SISTEMI ELEKTRONIK I MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE DHE INFRASTRUKTURA IT	31
AKSESI, TRANSPARENCA, MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE MEDIAN.....	33
ÇËSHTJET E INFRASTRUKTURËS, RUAJTJES DHE SIGURISË NË GJYKATË	37
ANALIZA E REALIZIMIT TË FONDEVE BUXHETORE	39
OBJEKTIVA	46
PËRFUNDIME.....	48
Aneks	50

HYRJE

Analiza e veprimtarisë së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (GJAJP) për vitin 2024, përshkruan veprimtarinë gjyqësore dhe administrative të saj duke pasqyruar performancën përsa i përket misionit të saj parësor, dhënies së drejtësisë duke evidentuar rezultatet e arritura në drejtim të gjykimit të çështjeve por edhe vështirësitë strukturore dhe infrastrukturore që përbëjnë sfidat kryesore të kësaj gjykate si gjykata e vetme në nivel apeli për juridiksionin e përgjithshëm (civil dhe penal) në Republikën e Shqipërisë, e cila filloi funksionimin në datën 01.02.2023.

Raporti vjetor përmban një përshkrim të përgjithshëm të organizimit të brendshëm të gjykatës, trupën gjyqësore, njësinë ligjore, të dhëna për çështjet e zgjidhura dhe mbartura, afatet kohore procedurale, menaxhimin e seancave gjyqësore, administrimin e gjykatës dhe procesin e punës në gjykatë, bashkëpunimin me aktorët e sistemit të drejtësisë, etj. Pavarësisht sfidave të mëdha, mungesës së burimeve njerëzore (gjyqtarë e ndihmës ligjorë) dhe problematikat e theksuara infrastrukturore, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, gjatë vitit 2024 është përpjekur që nëpërmjet vendimeve të realizojë misionin bazë të saj, dhënien e drejtësisë, si dhe të garantojë zhvillimin e një procesi të rregullt gjyqësor, duke gjykuar me një trupë gjyqësore prej 26 gjyqtarësh, 9850 çështje gjyqësore. Megjithatë, ajo qëndron ende larg qëllimit kryesor që pati reformimi i kompetencave tokësore (harta gjyqësore) përgjatë vitit 2023 i cili synoi jo vetëm ekuilibrimin e ngarkesës nëpër gjykata, por mbi të gjitha unifikimin e cilësisë së shërbimeve dhe drejtësisë së dhënë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet krijimit të një gjykate të madhe efikase nëpërmjet trupave gjyqësore të qëndrueshme, standardizimin e vendimmarrjes dhe rritjen e cilësisë së tyre.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e veprimtarisë së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm që prej themelimit të saj në vitin 2023, nëpërmjet bashkëpunimit të frytshëm dhe ndihmës efektive në zgjidhjen e problematikave të ndryshme të hasura gjatë këtij viti sfidues, në trajnimin e stafit të gjykatës me qëllim ngritjen e kapaciteteve të tyre në fushat përkatëse, si dhe në gatishmërinë për të mbajtur një frymë komunikimi dhe bashkëpunimi të vazhdueshëm. Megjithatë, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi qendror përgjegjës për mirëqeverisjen e gjyqësorit duhet të ishin bërë më shumë përpjekje përsa i përket mbarëvajtjes së punës në këtë institucion, duke zhvilluar me shpejtësi proceset e promovimit të gjyqtarëve dhe rritur progresisht numrin e tyre në gjykatë si dhe shtimin e ndihmësve ligjorë me qëllim që të rritej efienca dhe efikasiteti në gjykimin e çështjeve, duke u përkthyer në një shërbim më të mirë dhe më të shpejtë ndaj publikut. Sigurimi i një ambienti ku Gjykata e Apelit të ushtrojë

veprimtarinë saj me dinjitet, në respektim të solemnitetit të gjykimit dhe transparencës ndaj publikut nëpërmjet zhvillimit të seancave në salla gjyqi adekuate, në hyrje e dalje të veçanta për të mundësuar mënjanimin e komunikimit ex-parte, ku shërbimi ndaj qytetarëve të jepet në ambiente të krijuara posaçërisht për këtë qëllim edhe në respektim të aksesit për personat me aftësi ndryshe por edhe në ambiente të posaçme për ruajtjen dhe administrimin e arkivit aktiv të gjykatës (dosjeve gjyqësore të çështjeve në pritje të gjykimi) dhe sigurisë fizike në tërësi të stafit të gjykatës dhe qytetarëve, duhet të ishte prioritet i KLGJ.

Sikurse u theksua edhe më lart, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, vijon edhe në këtë vit të dytë të themelimit, të kryejë veprimtarinë e saj me një numër të pamjaftueshëm burimesh njerëzore, gjyqtarë dhe ndihmës ligjorë. Gjatë vitit 2024 kanë ushtruar detyrën efektivisht 26 gjyqtarë mesatarisht, të cilët kanë kompetencë tokësore mbi gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë për ankimet ndaj çështjeve penale dhe civile të ardhura nga 13 gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm në vend, si dhe çështjet e sjella për rigjykim nga Gjykata e Lartë. Pavarësisht prurjeve të reja që ka bërë Këshilli i Lartë Gjyqësor, përsëri ky numër është larg plotësimit të strukturës aktuale prej 78 gjyqtarë, që do ti mundësonte një frymëmarrje normale kësaj gjykate, arritjes së pritshmërive të reformës së hartës gjyqësor për një standardizim të gjykimit në nivel apeli, ngarkesës së ekuilibruar të gjyqtarëve në këtë nivel përkundër mesatares kombëtare vjetore të gjykimit të çështjeve prej 253 çështjes gjyqësore për gjyqtar në vit në mënyrë që të realizohet gjykimi i çështjeve në një afat sa më të shpejtë kohor dhe uljes së numrit të çështjeve të prapambetura (backlog-ut). Aktualisht mesatarja e çështjeve gjyqësore për gjyqtar ka qenë 534 çështje ndërsa numri i çështjeve të prapambetura arrin në 41700 çështje. Mungesa të theksuara paraqiten edhe pranë Njesisë Ligjore e cila përgjatë vitit 2024 ka vepruar me 22 ndihmës ligjorë, me një mesatare prej 0,8 ndihmës ligjor për gjyqtar. Ndërkohë stafi administrativ (nëpunës civil gjyqësor – sekretarë gjyqësor) qëndron në raportin 2.1 sekretarë gjyqësor për gjyqtar.

Plotësimi i trupës gjyqësore prej 78 gjyqtarësh dhe vendosja në funksionalitet të plotë e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm si e vetmja mënyrë për t'ju përgjigjur qytetarëve shqiptarë për dhënien e drejtësisë në kohë dhe me cilësi duhet të jetë prioriteti kryesor i Këshillit të Lartë Gjyqësor përgjatë vitit 2025. Madje ka ardhur momenti ku ky prioritet të tejkalohet qeverisjen e gjyqësorit dhe të ngrihet në një prioritet kombëtar e në fokus kryesor të institucioneve të pavarura me të cilat gërshetohet procesi i promovimit të gjyqtarëve por edhe të ekzekutivit dhe Kuvendit duke vendosur të gjitha burimet e nevojshme në dispozicion. Emergjente është edhe shtimi i numrit të ndihmësve ligjorë pranë njesisë ligjore duke

zhbllokuar mënyrën e rekrutimit të tyre në mënyrë që numri i tyre t'u përgjigjet volumit të punës në këtë gjykatë. Shtimi i numrit të personelit të strukturave mbështetëse në nivel nëpunësish civilë gjyqësorë po ashtu do të sillte dinamika të reja me qëllimin final dhënien e drejtësisë. Miratimi i ndryshimeve ligjore të propozuara nga Strategjia Kombëtare për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura dhe zbatimi i masave të tjera të parashikuara në të, duhet të jetë në fokus parësor të këtyre institucioneve. Volumi shumë i madh i çështjeve të prapambetura, pavarësisht përpjekjeve kolosale të trupës gjyqësore, stafit administrativ apo përmirësimit të vazhdueshëm të organizimit të punës, do të mund të evadohet vetëm nëpërmjet injektimit të të gjithë forcës gjyqësore dhe administrative të parashikuar për një funksionalitet të plotë të GJAJP.

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm vazhdon ta ushtrojë aktivitetin në të njëjtën godinë që ka patur Gjykata e Apelit Tiranë, një godinë prej tre katesh e përshtatur për gjykatë (jo e projektuar si e tillë prej themeleve), në të cilën janë të akomoduar të gjithë gjyqtarët dhe stafi administrativ dhe vendosur 7 sallat e gjyqit dhe salla e pritjes së qytetarëve. Kjo godinë nuk përmbush kushtet parësore që një gjykatë e këtij niveli duhet të përmbushë me qëllim që të realizojë funksionin e saj me dinjitetin, autoritetin dhe solemnitetin e nevojshëm, që për produkt të saj të ketë krijimin e lehtësirave në qasjen e publikut në marrjen e shërbimit administrativ apo atij gjyqësor, me salla gjyqi solemne, me hyrje e dalje të sigurta, me një organizim logjik të arkivit aktiv dhe zyrave të gjyqtarëve e stafit administrativ etj. Me rritjen e pritshme të numrit të gjyqtarëve dhe stafit mbështetës godina aktuale me një raport prej 4 gjyqtarë për sallë në vitin 2024, nuk plotëson më nevojat e kësaj gjykata dhe kërkon një zgjidhje emergjente dhe një vëmendje në nivel kombëtar por edhe një zgjidhje afatgjatë që t'i japë fund një herë e mirë kësaj problematike. ligjorë.

Duhet theksuar se sot që po zhvillohet kjo analizë, me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.173, Datë 20.03.2025, Për “Ndryshimin e Përgjegjësisë së administrimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të pronës me emërtimin “Dega e Tatimpaguesve të Mëdhenj”, ndodhur në Zonën Kadastrale 8150, me numër pasurie 6/227, Tiranë si dhe për një ndryshim në vendimin nr.818, datë 6.12.2006 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të ndryshuar”, është miratuar kalimi i godinës së ndodhur në zonën kadastrale 8150, me numër pasurie 6/277, Tiranë për t'u përdorur për ushtrimin e aktiviteteve administrative për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Me kalimin në administrim të KLGJ-së të kësaj godine, për GJAJP, vështirësitë që paraqiten për ta kthyer këtë godinë funksionale për veprimtarinë gjyqësore të

seksionit civil nuk duhet të na thyejnë, përkundrazi, duhet të mos rreshtim së përpjekuri për të marrë të gjitha masat për të mundësuar sa më shpejt të jetë e mundur zhvillimin normal të proceseve dhe krijimin e një ambienti të sigurt, si për gjyqtarët ashtu edhe për stafin administrativ, apo për palët dhe përfaqësuesit e tyre, por edhe për administrimin e dosjeve dhe arkivin e tyre.

Pavarësisht vështirësive, numrit të reduktuar të gjyqtarëve, mungesës së ndihmësve ligjorë dhe infrastrukturës së pamjaftueshme e të papërshtatshme, gjatë vitit 2024, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka përballuar një volum shumë të madh pune duke gjykuar 9850 çështje. Veprimtaria gjyqësore e GJAJP në vitin 2024 u karakterizua nga një përmirësim i lehtë i situatës lidhur me numrin e çështjeve gjyqësore të shqyrtuara apo në përgjithësi të të gjithë treguesve të performancës, shenjë e dedikimit të trupës gjyqësore dhe stafit administrativ të gjykatës. Megjithatë procesi i uljes së stokut vijon të mos jetë në hapat e duhura dhe pavarësisht përpjekjeve ai vjen në rritje për aq kohë sa numri i gjyqtarëve efektivë në detyrë qëndron pothuajse i njëjtë.

Norma e likuidimit të çështjeve për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm nuk paraqitet e kënaqshme edhe në rezultatet e arritura në fund të vitit 2024 edhe pse vjen në përmirësim. Standardi ndërkombëtar i pranuar që tregon një efikasitet të lartë të gjykimit është 100%, pra gjykata duhet të gjykojë brenda vitit kalendarik të njëjtin numër çështjes me numrin e çështjeve të reja të ardhura në gjykatë për atë vit. NLÇ për vitin 2024 në GJAJP rezulton në nivelin 71%, duke shënuar një rritje të lehtë në krahasim me vitin 2023 ku NLÇ ishte 68% por ende larg standardit ndërkombëtar. Megjithatë nëse kjo e dhënë ndërthuret me tregues të tjerë si numri i gjyqtarëve efektivë në gjykatë, **vlen të theksohet se GJAJP ka arritur të evadojë afro 70% të ngarkesës me vetëm afro 30% të trupës gjyqësore në shërbim. Gërshetimi i këtij treguesi thekson gatishmërinë dhe përkushtimin e gjyqtarëve dhe stafit administrativ të GJAJP për ti shërbyer qytetarëve pavarësisht vështirësive objektive.** Mirëpo ky rezultat tregon edhe se gjykata nuk është në gjendje të menaxhojë plotësisht ngarkesën e re të ardhur dhe vijon jo vetëm të mos evadojë stokun e çështjeve të prapambetura por të akumulojë gjithnjë e më shumë ngarkesë. Ndaj trupa gjyqësore e cilëson emergjencë kombëtare plotësimin e trupës gjyqësore të GJAJP.

Vlen të theksohet se sikurse ka qenë synimi i reformës së Hartës së re Gjyqësore, sigurimi i vazhdimësisë dhe aksesit të qytetarëve, pranë GJAJP ushtrojnë funksionin zyrtar e shërbimeve të cilat vijnë të qëndrojnë të hapura dhe funksionale pranë godinave të ish -gjykatave të apeleve në Shkodër, Durrës, Vlorë, Gjirokastrë dhe Korçë, në të cilat ushtrojnë veprimtarinë nëpunës civilë gjyqësorë të GJAJP të cilët

ofrojnë shërbimin ndaj publikut duke kryer shërbime administrative lidhur me protokollin, komunikimin e vendimeve/rekurseve dhe përcjelljen e tyre në gjykatat kompetente dhe arkivin gjyqësor. Këto zyra koordinohen nga Sektori i Protokollit, Arkivit dhe Koordinimit të Zyrave të Shërbimeve nën udhëheqjen e Kancelarit. Zyrat e shërbimit ushtrojnë komunikim të përditshëm e të menjëhershëm me qytetarët në territorin ku ushtrojnë veprimtarinë duke mundësuar ofrimin e shërbimit të publiku.

Pavarësisht ngarkesës me çështje gjyqësore të akumuluar ndërkohë, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar performancën e saj drejt objektivit të dhënies së drejtësisë, duke synuar përmirësimin cilësisë së vendimmarrjes, rritjen e shkallës së integritetit dhe besueshmërisë së publikut në veprimtarinë e saj.

ORGANIZIMI I TRUPËS GJYQËSORE

Edhe gjatë vitit 2024, GJAJP ka qenë subjekt i ndryshimeve të mëdha në strukturën e saj themelore, Trupën Gjyqësore. Gjatë vitit 2024 kanë ushtruar mesatarisht efektivisht detyrën 26 gjyqtarë në krahasim me vitin 2023 ku ushtronin detyrën mesatarisht 23 gjyqtarë. Edhe pse gjykata mirëpret emërimet e reja nga KLGJ të gjyqtarëve në përbërje të trupës gjyqësore, emërimet në periudha të ndryshme, në distancë nga njëra tjetra kërkojnë një riorganizim edhe ripërshtatje të vazhdueshme të dinamikave të brendshme të funksionimit të gjykatës, duke rikrijuar trupa të reja gjyqësore, rishortimet e çështjeve të cilat herë pas here kanë kërkuar një mobilizim të plotë të strukturave administruese për të siguruar një rishpërndarje të ngarkesës me qëllim ekuilibrimin e saj mes gjyqtarëve ekzistues dhe atyre të emëruar rishtazi. GJAJP mirëkupton që procesi i promovimit është një proces që nuk mund të sigurojë një prurje të gjyqtarëve të rinj në grup dhe mirëpret ardhjen e tyre sapo ky promovim është i mundshëm nga KLGJ mirëpo e shikon të udhës që edhe të sjellë në vëmendje vështirësitë që krijohen dhe vullnetin e gjyqtarëve dhe stafit administrativ të gjykatës për ti përballuar ato në mënyrën më të mirë brenda kushteve aktuale. Mungesa e një arkivi qendror për çështjet aktive, sjell edhe një vështirësi më shumë duke kërkuar një kohë dhe ndërmarrje të madhe nga i gjithë stafi i gjykatës për të identifikuar rishortimet, vendndodhjen fizike të dosjes gjyqësore apo edhe rishpërndarjen e organizimit të zyrave të gjyqtarëve dhe stafit që vështirësohet nga pamjaftueshmëria e tyre.

Përqindja e nr. të gjyqtarëve efektivë në GJAJP



Në fund të vitit 2024, GJAJP ushtronte funksionin me vetëm 33% të trupës gjyqësore të parashikuar. 67 % e trupës gjyqësore të parashikuar prej 78 gjyqtarësh mungon.

KLGJ gjatë vitit 2024, ka emëruar në periudha të ndryshme 3 gjyqtarë, sipas tabelës informuese më poshtë.

Gjyqtarë të emëruar nga KLGJ 2024	Periudha
Diamela Goxha	Shkurt 2024
Enkela Vlora	Shtator 2024
Anila Karanxha	Tetor 2024

Duke qenë se procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve ende vijon, nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit janë shkarkuar me vendim të formës së prerë, 6 gjyqtarë të cilët kanë qenë pjesë e strukturës së GJAJP.

Me vendimin nr.7, datë 26.02.2024, Për disa ndryshime në vendimin nr.1, datë 02.02.2023 të Këshillit të Gjykatës “Mbi krijimin e seksioneve dhe caktimin e gjyqtarëve në trupa gjykues, si dhe për caktimin e gjyqtarëve e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin dhe të mitur viktimë nga vepra penale”, u vendos se, Seksioni Penal do të përbëhej nga 14 gjyqtarë dhe ai Civil nga 12 gjyqtarë, pra përkatësisht nëntë trupa gjykuese: pesë në Seksionin Penal dhe katër në atë civil. Për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin dhe të mitur viktimë nga vepra penale janë caktuar gjithsej 4 gjyqtarë.

Seksioni Penal

Edlira Petri	Lutfije Celami	Brikena Ukperaj	Fuat Vjerdha
Fatri Islamaj	Miranda Andoni	Dritan Hasani	Genti Dokollari
Marsela Pepi	Qemal Zaimi	Genti Shala	Irena Brahimi

Diamela Goxha

Valdete Hoxha

Seksioni Civil

Arta Duka	Astrit Kalaja	Alma Ahmeti	Alma Kolgjoka
Sokol Pina	Elona Mihali	Elona Toro	Marsela Dervishi
Valbona Vata	Enkela Vlora	Iliba Bezati	Ornela Naqellari

Anila Karanxha

Irida Kacerja

Trupat gjyqësore të përbërë nga dy gjyqtarë plotësohen me një anëtar nga gjyqtarët e trupave të tjerë gjykues në seksionin përkatës me short sipas skemës së përcaktuar në vendimin e Këshillit të Gjykatës.

Përveç ngarkesës së çështjeve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, gjyqtarët e kësaj gjykate kanë përballuar edhe çështje të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për shkak të komandimeve pranë kësaj gjykate. Gjithashtu gjyqtarët e GJAJP janë pjesë e Kolegjit Zgjedhor si dhe Këshillit të Emërimeve të Drejtësisë, përfshirje e cila ndikon në reduktimin e mbulimit të ngarkesës me çështje të GJAJP.

NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR

Me vendimin nr.495, datë 21.10.2020, të KLGJ-së është vendosur krijimi i Njësive të Shërbimit Ligjor pranë gjykatave të apeleve. Struktura e Njesisë së Shërbimit Ligjor është e përbërë nga një numër prej 32 pozicionesh ndihmësish ligjorë. Për vitin 2024, ushtrojnë detyrën efektivisht 22 ndihmës ligjorë pasi një ndihmës ligjor është i pezulluar nga detyra me vendim të KPK-së në vitin 2024. Gjatë vitit 2024 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë emëruar vetëm 3 ndihmës ligjorë shtesë nga KLGJ. Edhe pse përbërja aktuale e trupës gjyqësore është e reduktuar në vetëm 26 gjyqtarë, numri i ndihmësve ligjorë efektivë në gjykatë nuk arrin të përmbushë standardin një ndihmës ligjor për gjyqtar të parashikuar nga ligji pasi aktualisht ndihmësit ligjorë janë të ndarë sipas trupave gjykues, pra dy ndihmës për një trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Numri aktual i ndihmësve ligjorë efektivë në gjykatë plotëson vetëm 69% të strukturës fillestare të miratuar nga KLGJ dhe vetëm 28% të nevojës sipas ligjit.

Përqindja e nr. të ndihmësve ligjorë në GJAJP



Në fund të vitit 2024, GJAJP mbështetet nga 22 ndihmës ligjorë, 28% e nevojave të kësaj gjykate përkundrejt raportit një ndihmës ligjor për gjyqtar të vendosur nga ligji për organizimin e pushtetit gjyqësor.



Numri i Ndihmësve Ligjorë Struktura të miratuar nga KLGJ	Numri i Ndihmësve Ligjorë efektivë në gjykatë	Numri i Ndihmësve Ligjorë sipas maksimumit të lejuar nga ligji	Përqindja përkundrejt nr. të miratuar nga KLGJ	Përqindja përkundrejt nr. të parashikuar nga ligji
32	22	78	69%	28%

Me vendimin nr.5, datë 03.03.2023, është miratuar “Formati Standard në përgatitjen e çështjeve nga njësia e shërbimit ligjor. Përveç punës së përditshme për kryerjen e relacioneve për dosjet gjyqësore që gjyqtarët planifikojnë për gjykim, ndihmësit kanë përfaqësuar gjykatën në të gjitha shkallët e gjykimit në proces gjyqësore.

Numri i ndihmësve ligjorë është shumë i ulët në raport me volumin e punës që duhet të kryejnë si dhe në raport me numrin e gjyqtarëve. Sikurse është vlerësuar edhe në Strategjinë e KLGJ për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura në gjykatat shqiptare, një nga zgjidhjet për të reduktuar numrin e çështjeve në pritje dhe çështjeve të prapambetura në gjykata është dhe rritja e kapaciteteve të personelit ndihmës gjyqësor. Aktualisht, krahas mungesës strukturore të gjyqtarëve, gjykata e apelit ka mungesa të theksuara të kapaciteteve në numra të ndihmësve ligjorë. Ky koncept është mirëpranuar edhe në vendet e tjera europiane, gjyqtarët ndihmohen nga personel mbështetës i kualifikuar por kjo është e vërtetë vetëm për një numër të kufizuar gjyqtarësh në Shqipëri. Procedura strikte e përzgjedhjes së ndihmësve/këshilltarëve ligjorë, e kombinuar me një trajnim paraprak dhe të detyrueshëm në Shkollën e Magjistraturës, si dhe interesi i ulët nga ana e profesionistëve të së drejtës për të ndjekur këtë karrierë, rezultojnë në mungesën strukturore të ndihmësve ligjorë. Megjithatë, nëpërmjet kësaj strategjie, Këshilli ka propozuar një alternativë ligjore që mund ta zgjidhë këtë problem dhe të çojë në rritjen e numrit të personelit mbështetës në gjykata. Ndryshimet ligjore të propozuara synojnë rritjen e numrit të ndihmësve ligjorë deri në dy ndihmës ligjorë për gjyqtar në gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, rritjen e trajtimit të tyre financiar si një mjet nxitës për përzgjedhjen e kësaj karriere nga ana e profesionistëve të së drejtës dhe lehtësimin e procedurave të rekrutimit të tyre duke parashikuar të njëjtën procedurë me rekrutimin e nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë në gjykata. Miratimi i këtyre ndryshimeve është thelbësor për rritjen e efikasitetit të GJAJP dhe uljen e çështjeve të prapambetura nëpërmjet rritjes së numrit të vendimmarrjes për gjyqtar duke maksimizuar kështu burimet e kufizuara të trupës gjyqësore.


BURIMET NJERËZORE

Në organikë GJAJP ka një strukturë të miratuar prej 245 pozicione punonjësish duke përfshirë trupën gjyqësore (78) dhe stafin administrativ (167). Numri faktik është më i vogël 152 pozicione të plotësuara, për shkak të largimeve të gjyqtarëve nga procesi i *vetting*-ut dhe mosplotësimit të gjykatës me gjyqtarë (26 nga 78), me ndihmës ligjorë (22 nga 32), me sekretarë gjyqësorë (55 nga 82) dhe staf tjetër administrativ mbështetës (49 nga 53).

Organika e stafit administrativ mbështetës (jo gjyqtarë)

Organika në strukturë	Organika në fakt	% përkundrejt strukturës	Raporti mbështetës/gjyqtar në strukturë	Raporti mbështetës/gjyqtar në fakt
167	126	75%	2.1	4.8

Përqindja e përmbushjes së pozicioneve kyç në drejtim të efikasitetit dhe uljes së çështjeve të prapambetura:



GJAJP mbështetet nga Kancelari dhe dy kryesekretarë, 55 sekretarë gjyqësorë, nga të cilët ushtrojnë funksione në zyrën e regjistrimit 5,2 për çështje civile dhe 3 për çështje penale. Struktura gjithashtu ka 2 nëpunës të teknologjisë të informacionit (IT), 1 NCGJ në arkiv, 1 NCGJ në protokoll, 1 Specialist me Media me Publikun, 1 specialist statistike, 1 Drejtor Drejtorie, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, 2 specialist buxheti, 2 specialist finance, 1 specialist burime njerëzore, 1

specialist mbështetës, 18 (shërbime mbështetës, ftues, nëpunës gjyqësor, mirëmbajtës, shofer, roje, sanitar), 1 shëf sektori, Sektori i Koordinimit të Zyrave të Shërbimeve dhe Protokoll/Arkivi. Zyrat e shërbimeve që ushtrojnë veprimtarinë në godinat e ish-gjykatave të apeleve në rretë, përbëhen nga tre nëpunës civilë gjyqësorë (përveç Zyrës së Shërbimit Korçë dhe Shkodër, në të cilat ushtrojnë detyrën dy punonjës për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të një nëpunësi në Zyrën e Shërbimit Korçë dhe të dhënies së dorëheqjes së nëpunësit në Zyrën e Shërbimit Shkodër).

Gjatë vitit 2024, janë shpallur vendet vakante për sekretarë gjyqësorë në total 25, nga të cilat janë plotësuar 6 me lëvizje paralele dhe 12 me procedurë pranim në shërbimin civil gjyqësor. Siç vihet re GJAJP nuk ka arritur të përmbushë të gjitha pozicionet e shpallura por vetëm 72% të tyre duke mos arritur të rekrutojë staf të mjaftueshëm të motivuar dhe të kualifikuar me aftësitë e nevojshme për tu përzgjedhur si NCGJ pranë kësaj gjykate.

Gjatë vitit 2024, kanë mbushur moshën e pensionit 2 sekretare gjyqësore dhe 1 specialist i burimeve njerëzore si dhe kanë dhënë dorëheqjen nga detyra 5 sekretare gjyqësore dhe 1 specialist IT dhe statistike, në total 6 nëpunës civilë gjyqësorë janë larguar nga gjykata përgjatë vitit 2024.

Për vitin 2024 është dhënë një masë disiplinore largim nga shërbimi civil gjyqësor për një sekretar gjyqësor dhe një masë disiplinore pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë për një periudhë 6 mujore për një nëpunës të zyrës së financës.


VEPRIMTARIA GJYQËSORE NË SHIFRA

TREGUESIT E NGARKESËS


Çështjet e reja të regjistruara

Me vënien në funksionim të GJAJP më shkurt të vitit 2023, sipas vendimit përkatës të KLGJ, GJAJP trashëgoi të gjitha çështjet gjyqësore të regjistruara në ish gjykatat e apelit, Tiranë, Durrës, Korçë, Shkodër, Gjirokastrë dhe Vlorë dhe që nuk kishin përfunduar, me një total prej 33, 731 çështje gjyqësore aktive. Përgjatë vitit 2023 (shkurt- dhjetor 2023) u regjistruan 12,146 çështje të reja, 5492 çështje civile dhe 6654 çështje penale. Çështje të reja të regjistruara në vitin 2024 janë 13,888, 5960 çështje civile dhe 7928 çështje penale. Në çështjet e reja të regjistruara në vitin 2024 përfshihen edhe 334 çështje të ardhura për rrjedhojë e vendimarrjes së Gjykatës së Lartë për prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe kthim e tyre për rigjykim po pranë kësaj gjykate.


Sikurse edhe bie në sy nga grafika kemi një rritje prej 14% të çështjeve të reja të regjistruara në GJAJP në krahasim me vitin 2023.




Sipas natyrës çështjet e reja të regjistruara në GJAJP përgjatë vitit 2024 në përqindje ndahen në 57% të ngarkesës e përbëjnë çështjet penale dhe 43% e përbëjnë ato të natyrës civile.



Çështjet civile të reja të regjistruara në GJAJP në vitin 2024, ndahen në dy lloje kryesore, me ose pa palë kundërshtare. Çështjet e reja civile me palë kundërshtare të regjistruara gjatë 2024 janë 3648 ndërsa ato pa palë kundërshtare janë 2312 çështje. Pra çështjet me palë kundërshtare, të përbëra nga çështje themeli zënë volumn kryesor të ngarkesës së çështjeve të natyrës civile duke përbërë 61% të çështjeve të reja.




Grafiku në vijim tregon një detajim të kategorive të çështjeve civile me palë kundërshtare ku volumn më të madh e zënë çështjet civile të përgjithshme. Ndër çështjet familjare të reja të regjistruara pranë GJAJP në vitin 2024, 296 prej tyre janë me objekt Zgjidhje Martese.



Në çështjet civile pa palë kundërshtare të reja të regjistruara në 2024, volumin më të madh e zënë ato të përgjithshme (2276) ndërsa ato të natyrës familjare edhe tregtare janë në numër shumë të ulët (përkatësisht 30 çështje familjare dhe 6 tregtare).


Çështjet penale të reja të regjistruara në GJAJP në vitin 2024, ndahen në tre lloje kryesore, sipas rëndësisë së veprës penale, në krime (3465) dhe kundërvajtje penale (110) si dhe ato të natyrës administrativo-penale (4353). Çështjet të natyrës administrativo-penale si masa sigurimi, lirim me kusht, ekstradime, zënë volumin kryesor të ngarkesës së çështjeve të natyrës penale duke përbërë 55% të reja penale, të ndjekura nga krimet në 44%.



Në çështjet penale administrative volumin më të madh e zënë masat e sigurimit (3132), ekstradime (30) dhe lirim me kusht (13). Ndër çështjet penale të reja të regjistruara në kategorinë Krime pranë GJAJP në vitin 2024, 373 prej tyre janë me objekt Dhuna në Familje.


Çështjet e shqyrtuara

Numri i çështjeve të shqyrtuara në total për vitin 2024 në GJAJP është 9850 çështje gjyqësore. Nga totali i çështjeve të gjykuara rezulton se janë gjykuara 6025 çështje penale dhe 3825 çështje civile.




Sikurse edhe bie në sy nga grafika kemi një rritje prej 20% të çështjeve të gjykuara në GJAJP në krahasim me vitin 2023.

Sipas natyrës çështjet gjykuara në GJAJP përgjatë vitit 2024 në përqindje ndahen në 61% të ngarkesës e përbëjnë çështjet penale dhe 39% e përbëjnë ato të natyrës civile.




Çështjet civile gjykuara në GJAJP në vitin 2024, ndahen në dy lloje kryesore, me ose pa palë kundërshtare. Çështjet civile me palë kundërshtare të gjykuara gjatë 2024 janë 1529 ndërsa ato pa palë kundërshtare janë 2296 çështje. Pra çështjet pa palë kundërshtare, të përbëra nga çështje të natyrës urgjente apo me kompleksitet më të ulët zënë volumnin kryesor të ngarkesës së çështjeve të natyrës civile duke përbërë 60% të çështjeve të gjykuara.



Grafiku në vijim tregon një detajim të kategorive të çështjeve civile të gjykuara me palë kundërshtare ku volumnin më të madh e zënë çështjet civile të përgjithshme.


Ndër çështjet familjare të gjykuara nga GJAJP në vitin 2024, 173 prej tyre janë me objekt Zgjidhje Martese.



Në çështjet civile pa palë kundërshtare të gjykuara në 2024, volumin më të madh e zënë ato të përgjithshme (2278) ndërsa ato të natyrës familjare edhe tregtare janë në numër shumë të ulët (përkatësisht 12 çështje familjare dhe 6 tregtare).

Çështjet penale të gjykuara në GJAJP në vitin 2024, ndahen në tre lloje kryesore, sipas rëndësisë së veprës penale, në krime (2151) dhe kundërvajtje penale (190) si dhe ato të natyrës administrativo-penale (3684). Çështjet të natyrës administrativo-penale si masa sigurimi, lirim me kusht, ekstradime, zënë volumin kryesor të ngarkesës së çështjeve të natyrës penale duke përbërë 61% të çështjeve të gjykuara, të ndjekura nga krimet në 36%.


Llojet e çështjeve penale të gjykuara 2024



Sikurse vihet re edhe nga të dhënat, për shkak të volumit të lartë të çështjeve për gjyqtar, gjyqtarët e GJAJP kanë trajtuar me prioritet çështjet penale që janë të karakterit urgjente. Në çështjet penale administrative volumin më të madh të çështjeve të gjykuara e zënë masat e sigurimit (3093), ekstradime (31) dhe lirim me kusht (12). Ndër çështjet penale të gjykuara në kategorinë Krime pranë GJAJP në vitin 2024, 197 prej tyre janë me objekt Dhuna në Familje.


Më poshtë grafika paraqet një vështrim krahasimor mes çështjeve të gjykuara përkundrejt çështjeve të regjistruara në gjykatë përgjatë viteve 2023-2024. Edhe në këtë pasqyrë të përgjithshme vihet re prirja në rritje e çështjeve të reja të regjistruara dhe prirja në rritje e vendimmarrjes së gjykatës.

Trendi në çështjet e regjistruara vs të gjykuara sipas viteve




Çështjet në pritje për gjykim

Sikurse u theksua edhe më lart, me vënien në funksionim të GJAJP më shkurt të vitit 2023, sipas vendimit përkatës të KLGJ, GJAJP trashëgoi të gjitha çështjet gjyqësore të regjistruara në ish- gjykatat e apelit, Tiranë, Durrës, Korçë, Shkodër, Gjirokastrë dhe Vlorë dhe që nuk kishin përfunduar, me një total prej 33, 731 çështje gjyqësore të pashqyrtuara. Pavarësisht përpjekjeve të trupës gjyqësore dhe shqyrtimit të 8215 çështjeve deri në fund të vitit 2023, me regjistrimin edhe të çështjeve të ardhura rishtazi, u mbartën për vitin 2024, 37,662, nga të cilat 11,682 natyrës penale dhe 25,980 natyrës civile. Nr. i çështjeve në pritje për gjykim në fund të vitit 2024 pavarësisht shqyrtimit të 9850, me regjistrimin e çështjeve të reja, arriti në 41,700 çështje, nga të cilat 28,115 çështje civile dhe 13,585 çështje penale. Numri i çështjeve në pritje për gjykim nga dhjetori 2023 në dhjetor 2024 është rritur me 11%.



Volumi i çështjeve në pritje për gjykim të ndara sipas natyrës së tyre për vitin 2024 paraqitet si më poshtë. 67% e çështjeve në pritje për gjykim përbëhet nga çështje civile dhe 33% nga çështje penale.

Natyra e çështjeve në pritje për gjykim




■ Numri i çështjeve civile të mbartura ■ Numri i çështjeve penale të mbartura


Të ndara sipas natyrës së çështjeve, ecuria e çështjet në pritje për gjykim paraqitet sipas grafikëve më poshtë.

Numri i çështjeve civile në pritje për gjykim nga dhjetori 2023 në dhjetor 2024 është rritur me 8%. Çështje civile me palë kundërshtare zënë volumn më të madh të çështje civile në pritje për gjykim, prej 82% në krahasim me 18% të atyre pa palë kundërshtare. Të ndara sipas kategorisë, çështjet civile të përgjithshme zënë volumn më të madh të çështjeve civile me apo pa palë kundërshtare në pritje për gjykim me përkatësisht 71% dhe 97%.

Numri i çështjeve civile në pritje për gjykim




Çështjet civile në pritje për gjykim sipas llojit




■ Çështje civile me palë kundërshtare ■ Çështje civile pa palë kundërshtare

Çështje civile me palë kundërshtare në pritje për gjykim





■ Të përgjithshme ■ Familjare ■ Tregtare ■ Marrëdhënie pune

Çështje civile pa palë kundërshtare në pritje për gjykim



■ Të përgjithshme ■ Familjare ■ Tregtare

Numri i çështjeve penale në pritje për gjykim është rritur me 17% në vitin 2024 në krahasim me të dhënat e vitit 2023. Të ndara sipas kategorisë, Krimet zënë volumn më të madh të çështjeve penale në pritje për gjykim, prej 71%, të ndjekura nga çështjet administrativo-penale me 20% dhe kundërvajtjet me 9%.




Sipas të dhënave të paraqitura deri më tani, në datën 01.01.2024, numri total i çështjeve gjyqësore të mbartura nga viti 2023 ishte 37,662, nga të cilat të 11,682 natyrës penale dhe 25,980 natyrës civile. Çështje të reja të regjistruara në 2024 janë 13888. Numri i çështjeve të shqyrtuara në total për vitin 2024 është 9850 çështje gjyqësore ndërsa numri i çështjeve në pritje për shqyrtim deri më 31.12.2024 arrin në total 41700 çështje, nga të cilat 28,115 çështje civile dhe 13,585 çështje penale.


Përmbledhje - Treguesit kryesorë të ngarkesës


Çështje të mbartura deri në 31.12.2023	Çështje të regjistruara të reja në vitin 2024	Çështje të gjykuara në vitin 2024	Çështje në pritje për gjykim deri në 31.12.2024
37.662	13.888	9850	41700

Përmbledhje - Treguesit kryesorë të ngarkesës



Treguesit kryesorë të ngarkesës sipas volumit të natyrës së çështjeve






Pavarësisht angazhimit serioz të gjykatës, përkushtimit dhe devotshmërisë të trupës gjyqësore dhe stafit administrativ të gjykatës, masave organizative në luftën ndaj *backlog*-ut, volumi i çështjeve të prapambetura vijon të mbetet në shifra alarmante dhe kërkon një përkushtim të të gjithë aktorëve me të cilët ndërlidhet procesi i promovimit të gjyqtarëve, KLGJ, ILD, KPA etj., bashkëpunëtorëve të gjykatës si prokuroria dhe përfaqësuesit e palëve por edhe Kuvendit për të miratuar nismat ligjore pjesë e Strategjisë Kombëtare për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura.

TREGUESIT E EFIÇIENCËS

Norma e Likuidimit të çështjeve


Norma e zgjidhjes/likuidimit të çështjeve apo raporti i thjeshtë i dalë nga pjesëtimi ndërmjet çështjeve të zgjidhura me çështjet e reja të regjistruara brenda një periudhë vjetore, i shprehur në përqindje) është një nga treguesit kryesorë të efikasitetit të gjykatës. Standardi ndërkombëtar i pranuar për një gjykatë efikase është që arrin të “likujdojë”/shqyrtojë një numër të barabartë çështjes me çështjet e reja të regjistruara, pra në rezultatin 100%.



NLÇ për vitin 2024 në GJAJP është 70.9 % duke treguar se gjykata nuk ka qenë e aftë të zgjidhë më shumë çështje se sa janë regjistruar për shqyrtim në vitin 2024, për rrjedhim një pjesë e çështjeve të reja janë mbartura nga viti i mëparshëm duke rritur kështu stokun e përgjithshëm të çështjeve të prapambetura. Gjykata jo vetëm që nuk arrin të reduktojë stokun e çështjeve të prapambetura por vijon të akumulojë/rrisë atë.

Gjithsesi vlen të theksohet se kjo normë likuidimi prej afro 71% është arritur nëpërmjet kontributit dhe përkushtimit të vetëm 33% të trupës gjyqësore të parashikuar për ngarkesën me çështje të gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm. Në krahasim me vitin 2023 kjo normë është rritur pasi në vitin 2023 NLÇ rezultonte 67.6 %.

Norma e Likuidimit të Çështjeve






Të ndara sipas natyrës së çështjeve NLÇ për vitin 2024 tregojnë këto rezultate:





Për çështjet e natyrës civile, NLÇ është 64.1% në vitin 2024 në krahasim me 61.8 në vitin 2023. Edhe në treguesin e NLÇ për çështjet civile ka një rritje të lehtë për vitin 2024 por ende larg standardit prej 100%. Seksioni civil punon me trupë gjyqësore të reduktuar.

Norma e Likuidimit të Çështjeve Civile



Për çështjet e natyrës penale, NLÇ për vitin 2024 është 75.9 % në krahasim me 72.4 në vitin 2023. Edhe në treguesin e NLÇ për çështjet penale ka një rritje të lehtë për vitin 2024 por ende larg standardit prej 100%. Seksioni penal punon me trupë gjyqësore të reduktuar.

Norma e Likuidimit të Çështjeve Penale




Koha deri në zgjidhjen e një çështjeje (ditë)




Koha deri në zgjidhjen e një çështjeje në ditë apo ndryshe Treguesi DT është raporti i numrit të çështjeve të pazgjidhura me numrin e çështjeve të zgjidhura gjatë periudhës së monitoruar shumëzuar me 365. Raporti tregon se sa shpejt gjykata punon mbi çështjet e marra, që do të thotë sa kohë duhet për një lloj të caktuar çështjeje për t'u zgjidhur. Ky tregues jep një perceptim se si gjykata menaxhon sasinë apo fluksin e çështjeve të ardhura.

Treguesi DT për vitin 2024 është 1545 ditë dhe krahasuar me të dhënat e vitit 2023 prej përkatësisht 1673 ditë pëson një rënie të lehtë prej 8%. I ndarë sipas natyrës së çështjeve, Treguesi DT për çështjet civile për vitin 2024 rezulton prej 2683 ditësh ndërsa për çështjet penale prej 823 ditësh. Krahasuar me të dhënat e vitit 2023, përkatësisht 2791 ditësh për çështjet civile dhe 885 ditësh për çështjet penale rezulton se kemi një rënie të lehtë të kohës deri në zgjidhjen e një çështjeje me 4% në çështjet civile dhe 7% në çështjet penale.


Të dhënat e këtij treguesi pasqyrojnë se gjykata në vitin 2024 po punon më shpejt se sa në vitin 2023, pavarësisht volumit të madh të çështjeve në pritje për tu gjykuar dhe pamjaftueshmërisë së trupës gjyqësore me vetëm 33% gjyqtarë përkundrejt organikës së plotë të parashikuar.



Grafikët më poshtë tregojnë kohën deri në zgjidhjen e çështjeve sipas detajimeve për llojet dhe kategoritë e çështjeve civile.





Grafikët më poshtë tregojnë kohën deri në zgjidhjen e çështjeve sipas detajimeve për kategoritë e çështjeve penale.




Mosha e çështjeve në pritje

Të kategorizuara sipas natyrës dhe kohës së pritjes, çështjet rezultojnë sipas grafikut të mëposhtëm. Vërehet se çështjet e regjistruara rreth 3-5 vite më parë nga viti i raportimit zënë numrin më të madh të çështjeve në pritje të gjyqimit prej 16602 (40%) çështje nga të cilat janë 13100 civile dhe 3338 penale. Vendi i dytë, me 6803 (16%), e zënë çështjet e kategorisë 1-2 vjet. Ndërsa 5608 (14%) çështje presin prej 2-3 vitesh për t'u shqyrtuar nga gjykata e apelit. Me moshën më të vjetër, me një pritje prej më shumë se 5 vitesh, rezultojnë 4254 çështje nga të cilat 2071 çështje penale dhe 2151 çështje civile, të cilat përbëjnë 10% të backlog-ut të vitit 2024.







Të ndara sipas natyrës panorama e moshës së çështjeve në pritje për gjykim shfaqet si në grafikët më poshtë. Çështjet civile me palë kundërshtare të regjistruara rreth 3-5 vite më parë nga viti i raportimit zënë numrin më të madh të çështjeve civile në pritje të gjyimit. 2151 çështjet civile me palë kundërshtare rezultojnë me një pritje prej më shumë se 5 vitesh.



Për çështjet civile me palë kundërshtare vërehet se çështjet civile të përgjithshme të regjistruara rreth 3-5 vite më parë nga viti i raportimit zënë numrin më të madh të çështjeve në pritje të gjyimit. Me moshën më të vjetër, me një pritje prej më shumë se 5 vitesh, rezultojnë 1858 çështje civile të përgjithshme.




Për çështjet civile pa palë kundërshtare vërehet se çështjet civile të përgjithshme të regjistruara rreth 2-3 vite më parë nga viti i raportimit zënë numrin më të madh të çështjeve në pritje të gjyimit. Me moshën më të vjetër, me një pritje prej më shumë se 5 vitesh, rezultojnë 32 çështje civile të përgjithshme pa palë kundërshtare.



Për çështjet penale vërehet se krimet e regjistruara rreth 3-5 vite më parë nga viti i raportimit zënë numrin më të madh të çështjeve në pritje të gjyimit. Me moshën

më të vjetër, me një pritje prej më shumë se 5 vitesh, rezultojnë 1878 çështje penale të natyrës krime.




Pavarësisht angazhimit serioz të gjykatës, përkushtimit dhe devotshmërisë të trupës gjyqësore dhe stafit administrativ të gjykatës, masave organizative në luftën ndaj backlog-ut, çështjet në pritje për gjykim tej afatit 2 vjeçar, në kundërshtim me jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut rezultojnë në shifra alarmante. Reduktimi i moshës së çështjeve në pritje për gjykim kërkon një përkushtim të të gjithë aktorëve me të cilët ndërlidhet procesi i promovimit të gjyqtarëve, KLGJ, ILD, KPA etj. për plotësimin e trupës gjyqësore, rritja e koordinimit me bashkëpunëtorët e gjykatës si prokuroria dhe përfaqësuesit e palëve për eliminimin e vonesave dhe rritjen e produktivitetit të seancave por edhe të Kuvendit për të miratuar nismat ligjore pjesë e Strategjisë Kombëtare për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura.


Kohëzgjatja e çështjeve të gjykuara

Megjithëse, situata e çështjeve në pritje të gjykimit paraqitet tejet problematike, vlen të analizohet edhe kohëzgjatja e çështjeve, të cilat janë likuiduar/gjykuar nga gjykata. Kështu gjatë vitit 2024 janë gjykuar një total prej 3,825 çështjesh civile nga të cilat, 2013 çështje që përbëjnë 53% të çështjeve të gjykuara kanë zgjatur mbi 2 vjet. Ndërkohë janë shqyrtuar gjithashtu 261 çështje ose 7% nga 1-2 vjet, 444 çështje ose 12% nga 6-12 muaj dhe 1107 çështje ose 28% të çështjeve në më pak se 6 muaj.

Në seksioni civil, prioritet i është dhënë gjykimit të çështjeve familjare, çështjeve me objekt zgjidhje martese, çështjet me objekt dëmshpërblim page, marrëdhënie pune si dhe kërkesa civile. Brenda afatit ligjor janë gjykuar kërkesat civile, me objekt Urdhër Mbrojtje.




Ndërsa për çështjet penale gjatë vitit 2024 janë gjykuar një total prej 6025 çështje nga të cilat, 1523 çështje që përbëjnë 25% të çështjeve të gjykuara kanë zgjatur mbi 2 vjet. Ndërkohë janë shqyrtuar gjithashtu 645 çështje ose 11% të çështjeve nga 1-2 vjet, 315 çështje ose 5% të çështjeve nga 6-12 muaj si dhe 3542 çështje ose 59% në më pak se 6 muaj.



Vlen të theksohet se gjatë vitit 2024, GJAJP ka shqyrtuar 3093 kërkesa penale të cilat janë gjykuara brenda afatit 10 ditor, të parashikuar në ligj nga gjyqtarët e gatshëm. Brenda afatit të parashikuar në ligj janë gjykuar edhe kërkesat penale lidhur me ekstradimet/njohjet e vendimeve penale të huaja.

Për shkak të numrit të lartë të kërkesave penale, edhe për vitin 2024 është përditësuar lista e gatishmërisë, në përputhje me vendimin “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e rasteve urgjente”, sipas listës së gatishmërisë, sipas rendit alfabetik me bazë shkronjën e parë të mbiemrit. Çdo javë janë 3 gjyqtarë të gatshëm, dhe kërkesat penale (masat e sigurimit, shuarje mase) urgjente pasi regjistrohen hidhen në short elektronik midis gjyqtarëve të gatshëm.

Shorti elektronik i masave të sigurimit i cili mundësohet nëpërmjet sistemit ICMIS është aplikuar për herë të parë në vitin 2023, për shkak se në listë gatishmërie ka më shumë se një gjyqtar të gatshëm. Nëpërmjet shortit elektronik realizohet shpërndarje e rastësishme dhe sa më e drejtë e çështjeve të regjistruara.



Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar gjithsej 19490 seanca gjyqësore nga të cilat 11766 seanca penale dhe 7724 seanca civile.

Pengesa të konsiderueshme në shpejtësinë e gjykimit edhe në vitin 2024 përbëjnë sistemi i shërbimeve postare të njoftimeve, mungesa e një sistemi të saktë adresash, mungesa e njohurive procedurale të punonjësve të postës që kryejnë njoftimet për llogari të gjykatës. Faktorët e jashtëm që kanë ndikuar në shpejtësinë në gjykim janë mosparaqitja e palëve në gjykim, paraqitja e kërkesave për shtyrje të seancës, nisur nga pjesëmarrja në gjykim tjetër, etj. Edhe përfaqësuesit ligjorë të palëve kërkojnë

në shumë raste shtyrje seance, për shkak të paaftësisë të shoqëruar me raport mjekësor/ në gjykime të tjera etj.

Ndër faktorët e tjerë të brendshëm që ndikon në shpejtësinë e gjykimit është evidente ngarkesa shumë e lartë në punë për secilin gjyqtar, referuar numrit mesatar të çështjeve për gjyqtar dhe organikës së gjykatës. Shkaqet e shtyrjes së seancave dhe zhvillimit të seancave joproduktive luajnë një rol të rëndësishëm në shpejtësinë e gjykimit.

TREGUESIT E NGARKESËS PËR GJYQTAR

Volumi i punës për gjyqtar

Tabelat dhe grafikët më poshtë paraqesin volumin e punës për çdo gjyqtar gjatë vitit 2024. Ajo që vihet re është se shpërndarja e ngarkesës së gjyqtarëve është pothuajse e barabartë, e realizuar kjo nëpërmjet shortit elektronik. Mirëpo nga analiza e të dhënave evidentohet fakti se ngarkesa e gjyqtarëve më çështje e kalon dukshëm ngarkesën mesatare që duhet të ketë një gjyqtar sipas qëllimeve të hartës së re gjyqësore prej 253 çështjesh për gjyqtar në nivel apeli.

Nr.	Gjyqtari	Nr. çështjeve të mbartura nga 31.12.2023	Nr. çështjeve të regjistruara të reja 2024	Nr. çështjeve të gjykuara 2024	Nr. Çështjeve në shqyrtim deri në 31.12.2024
1	Alma Kolgjoka	2211	601	416	1933
2	Alma Ahmeti	1994	595	393	1885
3	Anila Karanxha	0	100	22	1825
4	Arta Duka	2095	606	393	1961
5	Astrit Kalaja	2140	609	424	1932
6	Brikena Ukperaj	604	453	446	1073
7	Diamela Goxha	0	435	309	987


Nr.	Gjyqtari	Nr. çështjeve të mbartura nga 31.12.2023	Nr. çështjeve të regjistruara të reja 2024	Nr. çështjeve të gjykuara 2024	Nr. Çështjeve në shqyrtim deri në 31.12.2024
8	Dritan Hasani	1251	535	404	1063
9	Edlira Petri	1282	507	270	1179
10	Elona Mihali	1987	588	307	1955
11	Elona Toro	1894	610	476	1955
12	Enkela Vlora	0	147	44	1823
13	Fatri Islamaj	1229	477	364	1021
14	Fuat Vjerdha	1215	474	345	1042
15	Genti Dokollari	1228	519	434	1042
16	Genti Shala	1300	502	278	1145
17	Iliba Bezati	1980	555	425	1885
18	Irena Brahimi	1263	495	316	1178
19	Irida Kacerja	2017	581	468	1930
20	Lutfije Celami	1291	495	339	1087
21	Marsela Pepi	620	445	339	1172
22	Marsela Dervishi	1956	576	483	1877
23	Miranda Andoni	679	495	360	1237

Nr.	Gjyqtari	Nr. çështjeve të mbartura nga 31.12.2023	Nr. çështjeve të regjistruara të reja 2024	Nr. çështjeve të gjykuara 2024	Nr. Çështjeve në shqyrtim deri në 31.12.2024
24	Ornela Naqellari	1980	565	465	1926
25	Qemal Zaimi	633	470	295	1160
26	Sokol Pina	2094	598	387	1957
27	Valbona Vata	1956	600	431	1951
28	Valdete Hoxha	763	255	217	519


Të ndarë sipas seksioneve të dhënat paraqiten si më poshtë:

Seksioni Civil					
Nr.	Gjyqtari	Nr. çështjeve të mbartura nga 31.12.2023	Nr. çështjeve të regjistruara të reja	Nr. çështjeve të gjykuara	Nr. Çështjeve në shqyrtim deri në 31.12.2024
		2024	2024	2024	
1	Alma Kolgjoka	2211	601	416	1933
2	Alma Ahmeti	1994	595	393	1885
3	Anila Karanxha	0	100	22	1825
4	Arta Duka	2095	606	393	1961
5	Astrit Kalaja	2140	609	424	1932
6	Elona Mihali	1987	588	307	1955
7	Elona Toro	1894	610	476	1955
8	Enkela Vlora	0	147	44	1823
9	Iliba Bezati	1980	555	425	1885
10	Irida Kacerja	2017	581	468	1930
11	Marsela Dervishi	1956	576	483	1877
12	Ornela Naqellari	1980	565	465	1926
13	Sokol Pina	2094	598	387	1957
14	Valbona Vata	1956	600	431	1951

Seksioni Penal					
Nr.	Gjyqtari	Nr. çështjeve të mbartura nga 31.12.2023	Nr. çështjeve të regjistruara të reja	Nr. çështjeve të gjykuara	Nr. Çështjeve në shqyrtim deri në 31.12.2024
			2024	2024	
1	Brikena Ukperaj	604	453	446	1073
2	Diamela Goxha	0	435	309	987
3	Dritan Hasani	1251	535	404	1063
4	Edlira Petri	1282	507	270	1179
5	Fatri Islamaj	1229	477	364	1021
6	Fuat Vjerdha	1215	474	345	1042
7	Genti Dokollari	1228	519	434	1042
8	Genti Shala	1300	502	278	1145
9	Irena Brahimi	1263	495	316	1178
10	Lutfije Celami	1291	495	339	1087
11	Marsela Pepi	620	445	339	1172
12	Miranda Andoni	679	495	360	1237
13	Qemal Zaimi	633	470	295	1160
14	Valdete Hoxha	763	255	217	519



Ngarkesa me çështje për gjyqtar Seksioni Penal



■ Nr. çështjeve të mbartura nga 31.12.2023 ■ Nr. çështjeve të regjistruara të reja 2024

■ Nr. çështjeve të gjykuara 2024

■ Nr. çështjeve në shqyrtim deri në 31.12.2024

Nr. i çështjeve të gjykuara si relator




Tabela në vijim tregon numrin e çështjeve të gjykuara për gjyqtar si relator dhe si pjesëtar i trupit gjykues:

Nr.	Gjyqtari	Nr. çështjeve të gjykuara si relator	Nr. çështjeve të gjykuara si anëtar
1	Alma Ahmeti	393	547
2	Alma Kolgjoka	416	452
3	Anila Karanxha	22	14
4	Arta Duka	393	551
5	Astrit Kalaja	424	496
6	Brikena Ukperaj	446	358
7	Diamela Goxha	309	132
8	Dritan Hasani	404	378
9	Edlira Petri	270	260
10	Elona Mihali	307	556
11	Elona Toro	476	564
12	Enkela Vlora	44	31
13	Fatri Islamaj	364	358
14	Fuat Vjerdha	345	332
15	Genti Dokollari	434	324
16	Genti Shala	278	402
17	Iliba Bezati	425	519
18	Irena Brahimi	316	366
19	Irida Kacerja	468	455

Nr.	Gjyqtari	Nr. çështjeve të gjykuara si relator	Nr. çështjeve të gjykuara si anëtar
20	Lutfije Celami	339	341
21	Marsela Dervishi	483	419
22	Marsela Pepi	339	321
23	Miranda Andoni	360	390
24	Ornela Naqellari	465	484
25	Qemal Zaimi	295	376
26	Sokol Pina	387	549
27	Valbona Vata	431	478
28	Valdete Hoxha	217	150

Treguesi ËR - Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar.

STATISTIKAT PËR NGARKESËN DHE PRODUKTIVITETIN E GJYQTARËVE				
Numri i gjyqtarëve në gjykatë	Totali i çështjeve të reja të paraqitura për gjyqtar	Totali i çështjeve të gjykuara për gjyqtar	Totali i çështjeve për gjyqtar	Totali i çështjeve të mbartura për gjyqtar
26	534	379	1983	1604

Apo volumi total i punës për secilin gjyqtar bazuar në një llogari mesatare të ngarkesës për gjyqtar, duke pjesëtuar numrin total të çështjeve të regjistruara në vitin 2024 me numrin e gjyqtarëve të gjykatës, rezulton një mesatare prej 534 çështjes të caktuara për gjyqtar. Më shumë se dyfishi i ngarkesës mesatare me çështje të synuar nga harta e re gjyqësore pre 253 çështjesh për gjyqtar.

Nëse e krahasojmë këtë tregues më të dhënat e vitit 2023, prej 528 çështjes për gjyqtarë kemi një rritje të lehtë që kuptohet vjen nga rritja e numrit të çështjeve të regjistruara për vitin 2024 dhe qëndrimi pothuajse i njëjtë i numrit të gjyqtarëve efektivë në gjykatë

Ky tregues nxjerr në pah ngarkesën shumë të lartë në punë për gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe angazhimin e përhershëm të dëshmuar të secilit gjyqtar, të cilët kanë përballuar vitet e fundit një ngarkesë pune të pazakontë dhe në kushtet e pamundësisë objektive për të programuar dhe administruar normalisht çështjet në ngarkim të secilit prej tyre.

Treguesi NR - Norma e Rendimentit për Gjyqtar

Një tjetër tregues është raporti mbi numrin e çështjeve të gjykuara për çdo gjyqtar i cili llogaritet duke pjesëtuar numrin total të çështjeve të gjykuara në vitin 2024 me numrin e gjyqtarëve efektivë në gjykatë. Për vitin 2024 ky tregues qëndron në një mesatare prej 379 çështje të gjykuara për gjyqtar. Pavarësisht se numri i gjyqtarëve ka qëndruar i njëjtë me vitin 2023, vihet re se gjykata e ka rritur këtë tregues në krahasim me 357 çështje të gjykuara për gjyqtar në vitin 2023. Edhe një herë ky tregues pasqyron punën dhe dedikimin e trupës gjyqësore dhe stafit administrativ të gjykatës përkundrejt misionit të tyre pavarësisht vështirësive të shumta. Nëse gjykata do të punonte me kapacitet të plotë prej 78 gjyqtarësh, me një mesatare prej

379 çështje gjyqësore në vit do të ishin evaduar 29562 çështje gjyqësore, pra jo vetëm çështjet e regjistruara gjatë vitit do ishin gjykuar por do të ulej dhe backlogu i çështjeve të mbartura ndër vite, në një mesatare prej 15.600 çështje të mbartura në vit. Në një hark kohor prej 3 vitesh do të ishte evaduar backlogu i krijuar nga viti 2017 e në vijim, nëse gjykata do funksiononte me 78 gjyqtarë.

Ngarkesa e lartë e numrit të çështjeve të përfunduar për gjyqtar ka ndikuar në afatin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore dhe si rrjedhojë edhe në kryerjen me vonesë të veprimeve administrative lidhur me komunikimin e vendimeve.

Tregues të tjerë

Kontrolli i vendimmarrjes nga Gjykata e Lartë:

Për vitin 2024, në regjistrin e rekurseve janë regjistruar total 1119 rekurse, të çështjeve civile dhe penale. Në çdo rast për çështjet civile, gjyqtari merr paraprakisht vendimin lidhur me pranimin/mospranimin e rekursit.

Nga Gjykata e Lartë, për vitin 2024, janë kthyer për rigjykim 334 çështje civile dhe 18 penale, të cilat janë regjistruar dhe janë shortuar.

Delegimet e gjyqtarëve


Gjatë vitit 2024, gjyqtarët e Gjykatës të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë deleguar për të gjykuar çështje në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në total janë deleguar 6 gjyqtarë për gjykimin e çështjeve penale.

Delegimet sipas natyrës së çështjeve	Numri i delegimeve në vitin 2024
Penale	6
Kryesues	2
Anëtar	4

Kërkesat për heqje dorë nga gjykimi i çështjeve

Shkaqet kryesore të heqjes dorë nga gjykimi i çështjeve lidhen me pjesëmarrjen e gjyqtarëve në procese të tjera gjyqësore të lidhura apo vendimmarrje të mëparshme ku janë shprehur me vlerësime nga të cilat cenohet paanësia dhe parashikimi në ligj të mosshqyrtimit të një çështjeje nga gjyqtari që më parë ka gjykuar një çështje tjetër

të caktuar. Pjesë tjetër e rasteve të heqjes dorë nga gjykimi por më e pakët lidhet me vlerësimin e ekzistencës së arsyeve të tjera serioze të njëanshmërisë.




<i>Nr.</i>	<i>Gjyqtari</i>	<i>Miratime</i>	<i>Refuzime</i>
1	Alma Ahmeti	4	1
2	Alma Kolgjoka	7	0
3	Arta Duka	8	3
4	Astrit Kalaja	1	5
5	Anila Karanxha	2	0
6	Brikena Ukperaj	4	0
7	Dritan Hasani	6	1
8	Diamela Goxha	32	2
9	Edlira Petri	6	0
10	Elona Mihali	5	1
11	Elona Toro	7	2
12	Enkela Vlora	0	1
13	Fatri Islamaj	4	2
14	Fuat Vjerdha	4	1
15	Genti Dokollari	3	2
16	Genti Shala	2	2
17	Iliba Bezati	4	2
18	Irena Brahimi	6	1
19	Irida Kacerja	3	7
20	Luftije Celami	3	0
21	Marsela Dervishi	1	5
22	Marsela Pepi	2	0
23	Miranda Andoni	2	0
24	Ornela Naqellari	0	1
25	Sokol Pina	1	2
26	Qemal Zaimi	1	0
27	Valbona Vata	3	0
28	Valdete Hoxha	3	0
TOTAL		124	41

Përjashtimet e gjyqtarëve nga gjykimi i çështjeve

Nga analiza e rasteve të shqyrtimit të kërkesave për përjashtimin e gjyqtarëve vërehet se shkaku kryesor i pranimit të kërkesës për përjashtim është garantimi edhe në dukje i paanshmërisë së gjyqtarit. Shkaku i pushimit të kërkesave për përjashtim gjyqtari është shqyrtimi dhe pranimi i kërkesës së gjyqtarit për heqje dorë nga gjykimi. Ndërsa shkaqet kryesore të rrëzimit të kërkesës për përjashtim janë: mosparaqitja e arsyeve të njëanshmërisë nga ato të parashikuara në ligj si dhe mosdepozitimi i akteve për të provuar ekzistencës e arsyeve të njëanshmërisë.

Kërkesa për përjashtim gjyqtari	VITI 2024
Pranim	4
Pushuar	7
Rrëzim	27
Mospranim	20
Totali	58



Kërkesat për heqje dorë të kryetarëve/zv.kryetarëve të gjykatave të rretheve

<i>Nr</i>	<i>Gjykata përkatëse</i>	<i>Gjyqtari</i>	<i>Miratime</i>	<i>Refuzime</i>	<i>Totali</i>
1	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan	Matilda Fetau	2	2	8
		Artur Prenga	4	--	
2	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat	Ardiola Çela	1	--	3
		Klejda Meçi (Çapja)	--	2	
3	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier	Olkeda Lice	9	4	13
5	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë	Enkel Peza	12	--	12
6	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër	Sokol Shehu	2	--	4
		Egla Mirashi	2	--	
7	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë	Lirim Bulica	7	--	10
		Aurel Arapi	2	1	
9	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë	Alban Veçani	1	--	1
10	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë	Suela Dashi	--	1	2
		Marjola Beluli	--	1	
11	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës	Merita Karaj	1	2	6
		Florin Demollari	2	1	
12	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës	Paulin Çera	9	1	10
16	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë	Flamur Kapllani	1	1	2
17	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë	Ervin Sulaj	4	--	4
20	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër	Xhevdet Lika	3	--	3



Raporti për përdorimin e sistemit të regjistrimit audio

Siç shihet edhe nga tabela dhe grafika më poshtë, 82% e seancave gjyqësore janë zhvilluar në audio. Ky tregues nuk përfshin numrin e çështjeve për të cilat ligji parashikon zhvillimin në dhomë këshillimi pa praninë e palëve, përjashtimin e gjyqtarit për çështjet civile dhe penale, urdhrat e ekzekutimit e kërkesat penale me karakter sekret etj., të cilat nuk janë mbajtur në sistem audio. Në sistem audio, janë mbajtur të gjitha çështjet e tjera të gjykuara në Gjykatë.

Nëpunësit e administratës, sekretarisë gjyqësore të emëruar gjatë vitit 2024, janë trajnuar për përdorimin e sistemit audio, dhe kanë realizuar edhe transkriptimet e procesverbaleve të seancave gjyqësore audio, kur është kërkuar nga pala, si dhe janë zbatuar procedurat e dhënies së kopjeve të regjistrimit audio për palët. Zbatimi i këtij sistemi ka rritur ndjeshëm transparencën e gjykimit dhe ka ndikuar ndjeshëm në respektimin e rregullave të etikës dhe solemnitetit në gjykim.



Nr	Gjyqtar	Seanca të regjistrimit audio (SA)	Seanca të paregjistruara (SP)	Gjithsej (TOT)	Në % (SA/TOT *100)
1	Alma Ahmeti	687	143	830	82.80%
2	Alma Kolgjoka	475	81	556	85.40%
3	Anila Karanxha	41	11	52	78.80%
4	Arta Duka	672	17	689	97.50%
5	Astrit Kalaja	711	69	780	91.20%
6	Brikena Ukperaj	580	184	764	75.90%
7	Diamela Goxha	378	74	452	83.60%
8	Dritan Hasani	751	160	911	82.40%
9	Edlira Petri	457	52	509	89.80%
10	Elona Mihali	427	69	496	86.10%

11	Elona Toro	548	211	759	72.20%
12	Enkela Vlorë	82	26	108	75.90%
13	Fatri Islamaj	561	94	655	85.60%
14	Fuat Vjerdha	620	182	802	77.30%
15	Genti Dokollari	679	306	985	68.90%
16	Genti Shala	464	159	623	74.50%
17	Iliba Bezati	503	240	743	67.70%
18	Irena Brahimi	617	115	732	84.30%
19	Irida Kacerja	654	211	865	75.60%
20	Lutfije Celami	562	132	694	81.00%
21	Marsela Dervishi	481	181	662	72.70%
22	Marsela Pepi	464	132	596	77.90%
23	Miranda Andoni	780	75	855	91.20%
24	Ornela Naqellari	442	183	625	70.70%
25	Qemal Zaimi	480	77	557	86.20%
26	Sokol Pina	797	19	816	97.70%
27	Valbona Vata	801	14	815	98.30%
28	Valdete Hoxha	294	95	389	75.60%
Totali		15008	3312	18320	81.90%







Gjykata nga ka ardhur çështja

Nëse do të analizonim të dhënat e gjykatave nga kanë ardhur çështjet e reja, të dhënat tregojnë që peshën më të madhe të çështjeve të reja të regjistruara e zënë çështjet e ardhura nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me 48% pasuar nga ajo e Vlorës dhe e Fierit.





Të ndara sipas natyrës së çështjeve:









Nëse do të analizonim të dhënat e gjykatave nga kanë ardhur çështjet në pritje për gjykim, të dhënat tregojnë që peshën më të madhe të çështjeve në pritje për gjykim e zënë çështjet e ardhura nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me 50% pasuar nga ajo e Vlorës dhe e Fierit.




Të ndara sipas natyrës së çështjeve:







Llojet e vendimmarrjes



Të ndara sipas natyrës:





ZBATIMI I STRATEGJISË PËR ULJEN E NUMRIT TË ÇËSHTJEVE TË PRAPAMBETURA

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr.251, datë 09.05.2024, “Për miratimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata”, ka miratuar masa konkrete për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura. Gjithashtu, në funksion të zbatimit të kësaj Strategjie, lidhur me masat dhe procedurat për inventarizimin dhe klasifikimin e çështjeve të prapambetura, si edhe të procedurave dhe të kriterëve për shqyrtimin me përparësi të çështjeve, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar edhe udhëzimin nr.253, datë 09.05.2024 “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për analizimin dhe klasifikimin e çështjeve të prapambetura dhe çështjeve të reja që regjistrohen në gjykata” dhe Vendimin nr.254, datë 09.05.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.78, datë 30.05.2019, “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit”.

Në zbatim të kësaj Strategjie dhe akteve normative të sipërcituara, me urdhrin e Zëvendëskryetarit nr.201 prot., datë 22.05.2024, “Për organizimin e punës së inventarizimit dhe klasifikimit të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, u krijua ekipi për inventarizimin e çështjeve dhe klasifikimin e tyre. Në përbërje të këtij ekipi u caktuan 14 nëpunës civilë gjyqësorë, të cilëve u ngarkuan me përmbushjen e kësaj detyre, duke kufizuar për aq sa është e mundur angazhimin e tyre të zakonshëm në detyrat përkatëse funksionale të përhershme, angazhime të cilat gjithsesi janë po aq të rëndësishme dhe të domosdoshme për funksionimin normal të GJAJP. Ky ekip, pas trajnimit të nevojshëm me mbështetjen e Projektit të Asistencës pranë kësaj Gjykate “Ulja e Numrit të Çështjeve të Prapambetura dhe Përmirësimi i Efikasitetit”, i zbatuar nga East-West Management Institute filloi efektivisht veprimtarinë në Korrik 2024.

Inventarizuar gjithsej	Inventarizuar civile (2017-2020)	Inventarizuar penale (2017-2024)
19,255 çështje	6994	12,261
Prioritare	5322	3615

Deri në datën 31.12.2024, ekipi për inventarizimin e çështjeve dhe klasifikimin e tyre ka përpunuar rreth 19,255 dosje gjyqësore, të cilat i përkasin 12,261 çështjeve penale të regjistruara në vitet 2017-2024 dhe 6994 çështjeve civile të regjistruara në vitet 2017-2020. Ndërkohë po vijohet me inventarizimin e çështjeve të regjistruara sipas

relatorëve, deri në vitin 2024. Deri më tani, sipas të dhënave të përpunuara, 5322 çështje penale janë kategorizuar si prioritare për shqyrtim si dhe 3615 çështje civile. Pavarësisht problematikave objektive të lidhura me burimet njerëzore të kufizuara dhe domosdoshmërisë për të mos cenuar edhe veprimtaritë e tjera normale të administrimit të çështjeve, procesi për inventarizimin e çështjeve gjyqësore dhe klasifikimin e tyre do të vijojë në mënyrë të pandërprerë dhe parashikohet të përfundojë brenda vitit 2025.

Paralelisht me procesin e inventarizimit, për shkak të problematikave të lartpërmendura do të kërkojë kohë për përfundimin e tij të plotë, GJAJP ka vijuar me përpunimin e listave prioritare sipas gjyqtarëve dhe vitit të regjistrimit të çështjes duke evidentuar kategoritë prioritare dhe grup çështjet përkatëse. Me mbështetjen e 6 Nëpunësve për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura (NUNÇP), të angazhuar me mbështetjen e Projektit të Asistencës “Ulja e Numrit të Çështjeve të Prapambetura dhe Përmirësimi i Efikasitetit”, janë krijuar kushtet që GJAJP të vijojë paralelisht me procesin e kategorizimit të çështjeve prioritare, përpunimit dhe shqyrtimit të tyre. Ekipi i NUNÇP-ave ka filluar efektivisht veprimtarinë në muajin Korrik 2024, duke mbështetur gjyqtarët dhe trupat gjyqësore me përpunimin paraprak informacionit të përgjithshëm të çështjeve gjyqësore.

Për sa i përket masave të menaxhimit aktiv të çështjeve, si menaxhimi i diferencuar i çështjeve, filtrimi dhe grupimi i çështjeve, njëkohësisht me inventarizimin, është proceduar më tej me procesin e klasifikimit të tyre në bazë të një numri faktorësh, përfshirë llojin, natyrën, urgjencën, kompleksitetin etj. të mosmarrëveshjeve, investimin në rigjykim të kësaj gjykate për shqyrtimin e tyre, amnistisë, etj.

Mbi bazën e të dhënave të përpunuara lidhur me identifikimin e çështjeve me natyrë prioritare, kategorizimin e hollësishëm të tyre dhe gjyqtarët relatorë të caktuar për gjykimin e të tyre, në zbatim të ligjit nr.98/2016 i ndryshuar, si edhe të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.78, datë 30.05.2019, “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit”, i ndryshuar me vendimin nr. 254, datë 09.05.2024, Gjykata e Apelit ka zhvilluar Mbledhjen e Përgjithshme të Gjyqtarëve për të diskutuar dhe marrë mendimin e trupës gjyqësore në lidhje me mënyrën se si do të procedohet me përzgjedhjen dhe gjykimin e mundshëm të çështjeve të identifikuara në kategoritë më prioritare.


Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve ka mbajtur qëndrimin se, krahas shqyrtimit të çështjeve të tjera që do të caktohen për gjykim sipas radhës së regjistrimit të tyre, duhet të procedohet edhe me shqyrtimin e çështjeve gjyqësore të identifikuara me

natyrë prioritare. Ndërsa ndërmjet numrit të madh të çështjeve të kategorizuara si prioritare, Mbledhja shprehu qëndrimin se mund të procedohet me ato çështje që për vetë natyrën e tyre janë më urgjente, lidhjen me të drejtën e aksesit në gjykatë apo që për vetë natyrën e tyre nuk investojnë gjykatën në gjykim themeli, si edhe me disa çështje dhe kërkesa për shqyrtim me natyrë të thjeshtë si dhe në veprat penale për të cilat kanë përfituar amnisti.


Në vlerësim edhe të mendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve, në mbështetje të nenit 29 dhe 38, shkronja “gj”, të ligjit nr. 98/2016 i ndryshuar, të vendimit të KLGJ nr.251 datë 09.05.2024, vendimit të KLGJ nr.78, datë 30.05.2019, si edhe të pikës 6 dhe 7 të Udhëzimit të KLGJ nr.253, datë 09.05.2024, në datën 08.11.2024, Këshilli i Gjykatës ka miratuar vendimin nr.55, datë 08.11.2024 “Për krijimin e grupçështjeve me qëllim përmirësimin e shpejtësisë dhe efektivitetit të gjykimeve dhe uljen e çështjeve të prapambetura si dhe përcjelljen e tyre gjyqtarëve relator, për vlerësimin e shqyrtimit me përparësi”.


Në këtë vendim, duke pasur parasysh se deri në datën 2.10.2024 ishin inventarizuar 6994 dosje gjyqësore që i përkasin çështjeve të regjistruara në vitet 2017-2019, prej të cilave 3615 çështje u kategorizuar si prioritare. Këshilli i Gjykatës ka krijuar listat përkatëse të grup-çështjeve, për përgatitje dhe shqyrtim më me përparësi, me qëllim përmirësimin e shpejtësisë, të efektivitetit të gjykimeve dhe uljen e çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Këto lista të miratuara të grupçështjeve iu shpërndanë menjëherë për vlerësim gjyqtarëve relatorë për ti përgatitur për shqyrtim me trupat gjyqësore përkatëse. Mbi vlerësimet dhe udhëzimet e gjyqtarëve relatorë, NUNCP-at dhe ndihmësit ligjorë janë angazhuar në përpunimin paraprak të këtyre çështjeve gjyqësore dhe përgatitjen për gjykim. Ndërsa trupat gjykuese kanë proceduar me caktimin e datave për shqyrtim dhe gjykimin e çështjeve gjyqësore sipas listave përkatëse të këtyre grupçështjeve, krahas përgatitjes dhe shqyrtimit të çështjeve të tjera nisur nga radha e regjistrimit të tyre në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. .



Nga të dhënat statistikore rezulton se, për një periudhë rreth 6 mujore që ushtroi veprimtarinë e tij, duke filluar nga muaji Korrik 2024, ekipi i NUNÇP-ave ka tërhequr pranë gjyqtarëve për përpunim 1146 çështje (639 civile dhe 507 penale) dhe ka përpunuar relacionet përkatëse për 1146 çështje. Nga ana tjetër, deri në përfundim të vitit 2024 rezulton se, janë gjykuar nga trupat gjykuese 151 çështje civile dhe 106 çështje penale (në total 257) çështje të përpunuara paraprakisht nga Ekipi i NUNÇP-ave, ndërsa janë ende 889 çështje në pritje për tu gjykuar në muajt e parë të vitit 2025.





Për sa i përket objektivit të Strategjisë për miratimin e planeve individuale të veprimit, GJAJP gjatë vitit 2024 zgjodhi të mos miratojë ende një plan të tillë. Kjo qasje nisët nga volumi i madh i çështjeve të prapambetura dhe nevoja për zhvillimin me cilësi e për përfundimin sa më shpejt të procesit të inventarizimit të dosjeve gjyqësore. Bazuar edhe në këtë proces inventarizimi, është vlerësuar se do të ishte më efektive dhe e qëndrueshme për programimin e punëve sigurimi i të dhënave të plota nga ky inventarizim. Njëkohësisht, është vlerësuar se nevojitet një periudhë kalimtare veprimi me këtë kategori çështjesh të prapambetura dhe të listuara si prioritare, për të pasur indikatorë matës konkretë dhe për të kuptuar efektivitetin e atyre masave që janë ndërmarra deri më tani, për përpunimin, shqyrtimin dhe zgjidhjen e tyre.

Për sa i përket objektivit të Strategjisë për përdorimin e modeleve standarde të akteve dhe vendimeve gjyqësore, GJAJP ka hartuar dhe ka në përdorim modele standarde për hartimin e relacioneve nga NUNÇP-at dhe ndihmësit ligjorë, si edhe janë ndërmarrë masa të mëtijshme për përdorimin e modeleve dhe veprimeve të standardizuara për kryerjen e veprimeve dhe përpilimin e akteve procedurale. Mbi bazën e gjetjeve të deritanishme do të vijohet puna në të ardhmen për përmirësimin dhe shtimin e tyre.

Për sa i përket objektivit të Strategjisë për rritjen e bashkëpunimit institucional me aktorët kryesorë me të cilët ndërvepron gjykata, në vazhdimësi gjatë vitit 2024 ka patur bashkëpunim dhe mbështetje nga drejtuesi i Prokurorisë të Apelit, për implementimin e masave që lidheshin me reduktimin e kërkesave për shtyrje të gjykimit, etj. Gjykata ka vazhduar bashkëpunimin edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për masat e ndërmarra në kuadër të strategjisë siç janë:

Paraqitja e dokumenteve të kërkuara përpara seancës, komunikimi i shpejt me gjykatën edhe në rrugë elektronike.

Këshilli i Gjykatës ka kryer vazhdimisht takime me përdoruesit e gjykatës siç janë avokatët, prokurorët, shërbimi postar, individ, gazetar etj.

Një tjetër bashkëpunim shumë i ngushtë i gjykatës është edhe me Shkollën e Magjistraturës, në mbajtjen e një korrespondence të rregullt në lidhje me trajnimet për gjyqtarët, kancelarin dhe ndihmësit ligjorë.

MENAXHIMI ADMINISTRATIV I GJYKATËS

Mbledhja e përgjithshme e Gjyqtarëve

Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve ka kryer detyrat funksionale duke diskutuar çështjet kryesore që lidhen me problematikat e shumta me të cilat është dashur të përballlet GJAJP që prej fillimit të funksionimit të saj duke filluar nga nivelet e larta të stokut çështjeve të prapambetura, masat organizative që duhen marrë për reduktimin e tij, çështje të efikasitetit në tërësi të sistemit gjyqësor apo edhe infrastrukturën.

Këshilli i Gjykatës

Këshilli i Gjykatës gjatë vitit 2024, ka zhvilluar mbledhje periodike, në të cilat ka marrë 74 vendime për çështje të tilla si:

- Diskutimin dhe miratimin e projektbuxhetit për periudhën 2025-2027.
- Vendimmarrjen për caktimin e gjyqtarëve në përbërje të trupave gjyqësore, në Gjykatës të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm
- Vendimmarrja për krijimin e listave të grupçështjeve me qëllim përmirësimin e shpejtësisë, të efektivitetit të gjykimeve dhe uljen e çështjeve të prapambetura, si dhe përcjelljen e tyre gjyqtarëve relatorë për vlerësim e shqyrtim me përparësi.
- Miratimi i modelit të formularit të ankesës ndaj nëpunësve civilë gjyqësorë të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
- Rekrutimin për pranimin në shërbimin civil gjyqësor, si dhe shqyrtimin e ankimeve të kandidatëve.
- Vlerësimet e rezultateve në punë për NCGJ të, në zbatim të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit nr. 622, datë 10.12.2020 “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, si dhe udhëzimit të KLGJ nr. 85, datë 11.03.2021 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimin nëpërmjet konkurrimit të hapur” etj.
- Rishortimin e dosjeve gjyqësore;
- Dhënie masash disiplinore.

Kancelari

Kancelari si struktura përgjegjëse më e lartë e administrimit gjyqësor vijoi edhe gjatë vitit 2024 të marrë të gjitha masat e nevojshme administrative dhe organizative me qëllim kryerjen e detyrave funksionale në mënyrë efikase të përgjegjshme dhe transparente në drejtim të menaxhimit e administrimit të gjykatës pavarësisht vështirësive të mëdha që paserdhën pas vendosjes në funksionim të GJAJP në shkurt 2023, riorganizimit strukturor dhe infrastrukturor. Kancelari drejton strukturat përkatëse administrative në përmbushjen e detyrave të funksionale, koordinon bashkërendimin e tyre dhe mundëson të gjitha përpjekjet për përballimin e ngarkesës së punës së çdo sektori/drejtorie në gjykatë. Ndër detyrat kryesore të realizuara përmendim organizimin dhe hedhjen e shortit, mbikëqyrjen e mbledhjes dhe përpunimit të statistikave gjyqësore, krijimin e kushteve të përshtatshme në punë dhe riorganizimin e herëpashershëm të shpërndarjes në zyra për shkak të infrastrukturës së vjetër dhe papërshtatshme të gjykatës dhe shtimit të herëpashershëm të burimeve njerëzore, komunikimin me bashkëpunëtorët e gjykatës, KLGJ, publikun e median etj.

Kryesekretaria

Kryesekretaria dhe sekretaria gjyqësore kanë përballuar një volum shumë të lartë pune, duke regjistruar në total 13888 dosje gjyqësore si në sistemin elektronik ashtu edhe në regjistrat manualë të gjykatës. Nga punonjësit e zyrës se rekurseve janë kryer komunikimet e vendimeve gjyqësore të arsyetuara, si dhe rekurseve të paraqitura për to. Në total në Gjykatën e Lartë janë dërguar 1252 dosje gjyqësore (551 penale dhe 701 civile), kurse pjesa tjetër pas komunikimit të vendimi është dërguar në Gjykatat e Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Shërbimi i arkivit

Ka patur një numër të lartë kërkesash për shërbim nga arkivi i GJAJP si dhe nga arkiva e zyrave të shërbimit, për vënien në dispozicion të një kopje të dokumenteve arkivore, vendimeve që ndodhen në arkiv, apo informacione të tjera arkivore. Nga ana jonë qytetarëve i është shërbyer në një kohë të shkurtër dhe jo vetëm në Tiranë, por edhe në zyrat e shërbimeve. Kërkesat janë shqyrtuar dhe ju është dhënë përgjigje brenda afatit ligjor.

Numri i kërkesave drejtuar shërbimit të arkivit

TIRANË	630
DURRËS	606
VLORE	549
SHKODËR	470
GJIROKASTËR	298
KORÇË	273

Paralelisht, gjykata i është përgjigjur edhe kërkesave të institucioneve të ndryshme Konkretisht gjykata i është përgjigjur kërkesave të organeve të Vetingut me fotokopje të dosjeve gjyqësore gjykatave të shkallëve të para dhe prokurorive, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor. Gjykata është përballuar edhe me një numër shumë të lartë të kërkesave për fotokopje aktesh nga palët/përfaqësuesit e tyre, përmbushja e tyre ka kërkuar angazhimin e personelit të gjykatës dhe kohës efektive që mund të shpenzohej në detyra të gjykatës.

Gjatë vitit 2024, janë transferuar nga Zyra e Shërbimit Shkodër të gjitha dosjet gjyqësore dhe nga Zyra e Shërbimit Durrës dhe Vlorë janë transferuar dosjes gjyqësore të regjistruara deri në vitin 2019. Kjo për shkak të mungesës së hapësirës për arkivin e tyre pranë Godinës në Tiranë

Gjatë vitit 2024, ka vazhduar puna për dixhitalizimin e arkivit në gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, si dhe në arkivat e zyrave të shërbimeve, në zbatim të shkresës nr.2552/15, datë 19.07.2022 “Program dixhitalizimi i arkivave të gjykatës”.

Statistikat

Gjykata i është përgjigjur Këshillit të Lartë Gjyqësor, Ministrisë së Drejtësisë, dhe Institucioneve të tjera me informacion dhe të dhëna statistikore të kërkuara në periudha kohore 3 mujore dhe jo vetëm, të dhëna këto voluminoze dhe që, në të shumtën e rasteve, kanë kërkuar punë manuale dhe e gjithë kjo punë është përballuar nga specialisti i statistikave, nën mbikëqyrjen e Kancelarit.

Në vitin 2024 është kryer inspektimi tematik për shortin e vitit 2023 dhe gjykata i është përgjigjur ILD-së duke i vendosur në dispozicion informacionin e kërkuar së bashku me dokumentacionin dhe me tabelat e plotësuar për të gjitha çështjet gjyqësore. Një sekretar gjyqësor është marr me komunikimin me ILD/në, për shkak të inspektimit.

Spektori i Protokollit, Arkivës dhe i Koordinimit të Zyrove të Shërbimit

Spektori i Protokollit/ Arkivës dhe Koordinimit të Zyrove të Shërbimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka në organikën e tij 18 (tetëmbëdhjetë) nëpunës gjyqësorë civilë, konkretisht: Shef sektori-1, Specialist protokollit-1, specialist arkive-1, nëpunës gjyqësorë civilë pranë zyrove të shërbimit - 15.

Në respektim të parimeve të parashikuara në Ligjin për Pushtetin Gjyqësor dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e informimit, si dhe legjislacionin në fushën e arkivave shtetërore, Spektori i Protokollit dhe Arkivës, ka marrë të gjitha masat për të ruajtur dhe administruar gjithë aktet që lidhen me veprimtarinë gjyqësore dhe administrative të gjykatës, me qëllim ruajtjen dhe shfrytëzimin e tyre, si pjesë e trashëgimisë kombëtare.

Janë përpunuar, inventarizuar dhe dorëzuar në Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor (ASHSGJ), Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (DPA), të dokumentacionit RHK, dhe kanë filluar praktikën për asgjësim të dokumentacionit administrativ, dhe jo administrativ (dosjet gjyqësore) që e kanë humbur vlerën e shfrytëzimit dhe nuk ka lindur nevoja e zgjatjes së afatit të tyre, referuar ligjit për arkivat nr. 9154 datë 06.11.2003, i ndryshuar, ligji 27/2024, normave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, rregullore nr.202, datë 15.05.2023, etj.

Konkretisht janë transferuar:

- fondi i përhershëm i dosjeve gjyqësore i fondkrijuesit Gjykata e Apelit Tiranë periudha 1989-2009 pranë ASHSGJ.
- fondi i përhershëm i dosjeve gjyqësore i fondkrijuesit Gjykata e Apelit Shkodër për periudhën 1998-2000 pranë ASHSGJ.
- fondi administrativ, RHK i Gjykatës Ushtarake të Apelit Tiranë periudha 1993-2000 pranë DPA.
- fondi administrativ, RHK i Gjykatës së Apelit Shkodër periudha 1998-2000 pranë DPA.
- fondi administrative, RHK i Gjykatës së Apelit Korçë periudha 1998-2000 pranë DPA.
- fondi administrativ, RHK i Gjykatës së Apelit Vlorë periudha 1998-2000 pranë DPA.
- fondi administrativ, RHK i Gjykatës së Apelit Durrës periudha 1998-2000 pranë DPA.

- fondi administrativ, RHK i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë periudha 1998-2000 pranë DPA.

Gjithashtu është kryer asgjësimi i dosjeve gjyqësore me afat të përkohshëm të fondkrijuesit Gjykata e Apelit Shkodër për vitin 1998-2000, është në procedurë përpunimi fondi i përhershëm i dosjeve gjyqësore i fondkrijuesit Gjykata e Apelit Durrës për periudhën 1998-2000, praktikë e filluar më datë 11.11.2024. si dhe është në procedurë përpunimi fondi i përhershëm i dosjeve gjyqësore i fondkrijuesit Gjykata e Apelit Gjirokastrë për periudhën 1998-2000, praktikë e filluar më datë 25.11.2024.

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në zbatim dhe të shkresës nr. 500 prot. datë 24.12.2024 ka realizuar blerjen e kutive dhe dosjeve të standardit të kutive dhe dosjeve arkivore për ruajtje të përhershme në zbatim të vendimit të Këshillit të Lartë të Arkivave nr. 5/2019 të ndryshuar me vendimin nr. 7/2024.

Zyrat e Shërbimit

Pranë GJAJP ushtrojnë funksionin zyrat e shërbimeve të cilat vijnë të qëndrojnë të hapura dhe funksionale pranë godinave të ish-gjykatave të apeleve në Shkodër, Durrës, Vlorë, Gjirokastrë dhe Korçë, në të cilat ushtrojnë veprimtarinë nëpunës civilë gjyqësorë të GJAJP të cilët ofrojnë shërbimin ndaj publikut duke kryer shërbime administrative lidhur me protokollin, komunikimin e vendimeve/rekurseve dhe përcjelljen e tyre në gjykatat kompetente dhe arkivin gjyqësor. Këto zyra koordinohen nga Sektori i Protokollit, Arkivit dhe Koordinimit të Zyrave të Shërbimeve nën udhëheqjen e Kancelarit. Zyrat e shërbimit ushtrojnë komunikim të përditshëm e të menjëhershëm me qytetarët në territorin ku ushtrojnë veprimtarinë duke mundur ofrimin e shërbimit të publiku.

ZYRAT E SHËRBIMIT



ÇFARË JANË ZYRAT E SHËRBIMIT?

- Zyrat e Shërbimit janë struktura të cilat ngrihen dhe funksionojnë pranë godinave të ish Gjykatave të Apeleve Durrës, Korçë, Gjirokastrë, Vlorë dhe Shkodër me qëllim ofrimin e shërbimeve administrative që lidhen me protokollin dhe arkivin gjyqësor.
- Zyrat e Shërbimit janë pjesë e Sektorit të Protokollit, Arkivës dhe të Koordinimit të Zyrave të Shërbimit, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
- Kancelari i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe funksionimin e zyrave të shërbimeve dhe siguron koordinimin me shërbimet e tjera të gjykatës.

CILAT JANË FUNKSIONET E ZYRAVE TË SHËRBIMIT NË PERIUDHËN KALIMTARE?

- Nepunësit e Zyrave të Shërbimit, kryejnë të gjitha detyrat e sekretarit gjyqësor si dhe veprimet që lidhen me administrimin e dosjeve gjyqësore të çështjeve të përfunduara deri në datën 31 Janar 2023, të tilla si:
- komunikimin e vendimeve gjyqësore palëve ndërgjyqëse;
 - komunikimin e rekursit/kunder-rekursit palëve ndërgjyqëse në çështjet civile dhe përcjelljen e dosjes gjyqësore me aktet e plota për vlerësim nga gjyqtari relator në lidhje me lejimin e rekursit;
 - komunikimin e rekursit palëve ndërgjyqëse në çështjet penale dhe përcjelljen e dosjes gjyqësore me aktet e plota për në Gjykatën e Lartë;
 - përcjelljen për në gjykatat e rretheve gjyqësore përkatëse, të dosjeve gjyqësore për çështjet e përfunduara për të cilat nuk është ushtruar rekurs;
 - kryerjen e veprimeve lidhur me arkivimin e dosjeve të çështjeve të juridiksionit fillestar, për të cilat nuk është ushtruar rekurs;
 - kryerjen e detyrave të tjera sipas nevojës dhe delegimit nga Kancelari i Gjykatës.

KËRKESAT QË MUND TË PARAQITEN NËPËRMJET ZYRAVE TË SHËRBIMEVE NË RRETHE

- Kërkesë/Kërkesëpadi që gjykohej si shkallë e parë në Gjykatën e Apelit Juridiksionit të Përgjithshëm;
- Kërkesat për plotësim, sqarim, interpretim vendimi dhe ndreqje gabimi;
- Kërkesë për kopje vendimi/akteve nga Zyra e Arkivës;
- Kërkesë për kopje të akteve për çështje gjyqësore në proces;
- Rekursel/kundërrekursel;
- Kërkesë për vërtetim mbi çështjet e gjykuara apo në gjykim;
- Kërkesë për informacion mbi çështjet e regjistruar në gjykatë;
- Kërkesë për përshpejtim të çështjeve gjyqësore të regjistruara;
- Kërkesat për depozitim të të dhënave të kontaktit të palëve apo përfaqësuesve të tyre për çështjet gjyqësore në proces si dhe çdo të dhënë për ndryshimin e adresave të vendbanimit;
- Depozitim të aktit të përfaqësimit të çështjeve gjyqësore të regjistruara;
- Kërkesa për përjashtim të trupi gjyqësor në çështjet civile;
- Kërkesat për heqje dorë ankimi;
- Kërkesat për informacion të publikut dhe medias;
- Kërkesat për çështjet gjyqësore në proces.

KËRKESAT QË DUHET TË PARAQITEN VETËM NË GJYKATËN E APELIT JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

- Kërkesë përjashtim të gjyqtarit në çështje penale;
- Shuarje mase sigurimi në procesin penal;

Adresa e Gjykatës:

Bulevardi "Zhan D'Ark"
(Godina aktuale e Gjykatës së Apelit Tiranë)

Kontakte:

sherbime@gjykata.gov.al
+355 67 73 74 414
+355 67 73 74 414

SISTEMI ELEKTRONIK I MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE DHE INFRASTRUKTURA IT

Në Gjykatën e Apelit që prej vitit 2007 aplikohet sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve gjyqësore (ICMIS). Pavarësisht problematikave të evidentuara në mënyrë të vazhdueshme për funksionimin e këtij sistemi dhe disa zgjidhje të ofruara në vijimësi, ende mbeten për zgjidhje disa problematika, ku ndër më kryesorët renditen:

- mosgjenerimi i të dhënave statistikore dhe raporteve të tjera të sakta dhe sipas modelit të kërkuar, në funksion të statistikave të kërkuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor apo Ministria e Drejtësisë.
- moskryerja e një sërë funksionesh, si mospërrjashtimi automatik nga gjykimi në themel i çështjes i gjyqtarëve që kanë shqyrtuar kërkesat në fazën e hetimeve dhe në seancë paraprake njëkohësisht, pa qenë e nevojshme kryerja e veprimeve të tjera nga përdoruesi si rishortimi i çështjes, etj.

Pajisjet kompjuterike me të cilat punojnë gjyqtarët dhe stafi janë prodhim i vitit 2011 deri në vitin 2024. Shtimi i organikës së gjykatës gjatë vitit 2024 ka sjellë si problematikë rritjen e nevojës për më shumë kompjuterë në dispozicion. Në gjykatë punohet kryesisht me programin Word 2016 - 2019, me kompjuteri kryesor FUJITSU, ACER, HP, Lenovo etj. Programet që përdorin stafi i gjykatës në përgjithësi është i kategorizuar si më poshtë:

Programet		+ 100% e gjyqtarëve
Asistencë e drejtpërdrejtë për gjyqtarin/nëpunësin e gjykatës	Përpunimi në paketën Microsoft Office	☐
	Baza e të dhënave elektronike të jurisprudencës	☐
	Dosje elektronike (CCMIS)	☐
	Lidhje me internet	☐
Administrim dhe menaxhim	Sistemi i regjistrimit të çështjeve (CCMIS)	☐
	Sistemi i informacionit të menaxhimit të gjykatës (CCMIS)	☐
	Sistemi i informacionit financiar (Kreatx)	☐
Sistemi Audio/Video	FTR AUDIO SYSTEM	☐
	Formularë elektronikë	☐
Komunikim ndërmjet gjykatës dhe palëve	Faqe zyrtare e gjykatës	☐

Përveç punëve rutinë, zyra e IT-së, gjatë vitit 2024, Zyra e IT-së ka asistuar Këshillin e Gjykatës në shpërndarjen e ngarkesës në mënyrë sa më të balancuar dhe transparente ndërmjet gjyqtarëve ekzistues dhe atyre të ardhur të rinj. Janë ndërtuar tabelat e ngarkesës së gjyqtarëve të kategorizuara në vite dhe në objekt në mënyrë që ngarkesa të shpërndahet sa më drejtë. Me ndryshimet e reja që janë zhvilluar në sistemin ICMIS është bërë e mundur që të bëhet rishpërndarja e çështjeve direkt nga sistemi.

Në bazë të vendimit nr.8, datë 26.02. 2024 “Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore”, të Këshillit të Gjykatës është bërë rindarja me short midis gjyqtarëve Znj. Diamela Goxha, të çështjeve penale të cilat nuk janë shpallur për gjykim nga gjyqtarët e seksionit penal.

Në bazë të vendimit nr.47, datë 21.10. 2024 “Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore”, të Këshillit të Gjykatës është bërë rindarja me short midis gjyqtarëve Znj. Enkela Vlora dhe Znj. Anila Karanxha, të çështjeve civile të cilat nuk janë shpallur për gjykim nga gjyqtarët e seksionit civil.

Prej datës 01.02.2023, me short elektronik bëhet edhe ndarja e çështjeve (masa sigurimi), me karakter të ngutshëm sipas listës së gatishmërisë.

Kërkesat e vendimit të Këshilli të Lartë Gjyqësor Nr. 55 datë 29.12.2022” Për procedurat e ndarjes së çështjeve me short”, janë respektuar në mënyrë rigoroze në lidhje me ndarjen e çështjeve me short si dhe është rritur transparenca e këtij procesi, duke u publikuar paraprakisht koha e realizimit të shortit, duke u garantuar pjesëmarrja e publikut, si dhe duke u afishuar online në faqen zyrtare të gjykatës. Nëpërmjet përcaktimit të vendit të zhvillimit të shortit dhe rishortimit në sallën e gjykatës, të pajisur me monitor, është rritur aksesimi nga pjesëmarrës të tjerë të interesuar si palët, avokatët mbrojtës, media. Nga të dhënat statistikore rezulton se çështjet janë shpërndarë në mënyrë pothuajse të barabartë për të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë edhe numrin e çështjeve të regjistruara gjatë gatishmërisë, të cilat shortohen elektronikisht midis gjyqtarëve të gatshëm.

Shorti elektronik është hedhur çdo ditë, në orën 15:00 në sallën e gjykimit dhe të nesërmen është shpërndarë tek gjyqtarët relator, me praktikën e dosjes.

Gjatë vitit 2024 është bërë e mundur që seancat gjyqësore të regjistrohen në formatin Audio dhe Video.

Në Dhjetor të vitit 2024 ka përfunduar rikonstrukcioni i rrjetit të ri elektrik dhe kompjuterik duke sjellë një përmirësim të ndjeshëm në rritjen e aksesimit të sistemit elektronik dhe plotësimin e nevojave të stafit të gjykatës.

AKSESI, TRANSPARENCA, MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE MEDIAN

Qëllimi themelor i Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, është sigurimi i një publiku të informuar në një kohë sa më të shpejtë dhe një administratë llogaridhënese. Këto janë jetike për funksionimin e një shoqërie demokratike dhe paraqiten si domosdoshmëri për të sfiduar korrupsionin dhe për të siguruar përgjegjshmërinë e zyrtarëve. Rritja e besueshmërisë së publikut ndaj sistemit gjyqësor në përgjithësi, si dhe përmirësimi i shërbimeve duke rritur sasinë e informacionit publik është qëllim në vetvete i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur Programi i Transparencës për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Nëpërmjet këtij programi përcaktohet korniza ligjore e veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ndërton dhe rrit transparencën në punën e saj institucionale. Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nëpërmjet pasqyrit të tij në faqen zyrtare të gjykatës së Apelit, pranë portalit www.gjykata.gov.al. Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka marrë të gjitha masat për respektimin maksimal të të gjitha detyrimeve të rrjedhura nga ky ligj, duke publikuar në faqen e saj elektronike zyrtare informacionin dhe dokumentacionin e disponuar prej saj, të parashikuar nga ligji, për publikim kryesisht nga autoriteti publik.

Përsa i përket kërkesave për informim, për vitin 2024 rezultojnë të regjistruara gjithsej 24 kërkesa në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, duke specifikuar se janë regjistruar ato kërkesa që kanë ardhur në respektim të nenit 11, të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Por duhet theksuar se pranë zyrës së protokollit janë protokolluar edhe shumë shkresa/kërkesa me shkrim ose në format elektronik. Gjatë vitit 2024 ka patur një numër shumë të lartë kërkesash për informacion dhe nga ana e Zëvendëskryetares dhe Kancelares janë trajtuar rreth 3.000 shkresa. Gjykata ka kthyer përgjigje, në rrugë elektronike, dhe ka dhënë orientimet e nevojshme për qytetarët që të mund të drejtohen pa vështirësi në gjykatë për të marrë informacionin e nevojshëm me anë të formularëve elektronikë apo informacionit që gjendet në faqen zyrtare web të gjykatës.

Gjithashtu një numër të lartë përbëjnë edhe kërkesat për përshpejtim gjykimi dhe fotokopje të dosjeve gjyqësore, për të cilat nuk është dhënë ende një vendim përfundimtar.

GJAJP ka vijuar edhe gjatë vitit 2024 përditësimin dhe plotësimin e Rubrikës “Kreu”, në faqen zyrtare të internetit, me material ilustrues, orar shërbimi, kontakt telefonik dhe email komunikimi të gjykatës me publikun si dhe të Koordinatorës së Marrëdhënies me Median dhe Publikun. Është vijuar publikimi në Rubrikën “Njoftime për Publikun” si dhe “Njoftime të tjera”, në faqen zyrtare të internetit, i materialeve të përgatitura nga Këshilli i Gjykatës si dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, me qëllim informimin e Publikut në lidhje me funksionimin e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm si dhe të Zyrave Shërbimit, në kuadër të zbatimit të “Hartës së Re Gjyqësore”. Ndërkaq akte të tjera administrative që kanë të bëjnë me procedurat në gjykatë, me karakter të përgjithshëm, janë publikuar edhe ato rregullisht në faqen e internetit të gjykatës. Publikimi për informim i çdo urdhri të brendshëm të titullarit, si dhe vendimmarrjeve të Këshillit të Gjykatës, me karakter të përgjithshëm të cilat përpilohen në funksion të menaxhimit të punës në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, është kryer nën kujdesin e veçantë të koordinatorit për të drejtën e informimit me qëllim rritjen e transparencës, paanësisë së administratës gjyqësore, aktivitetit të saj, rregullimin e brendshëm si dhe shërbimit ndaj publikut.

Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, referuar legjislacionit në fuqi. Koordinatori për të drejtën e informimit, vazhdon të ketë një nga sfidat më të mëdha zbatimin e udhëzimit nr. 4059/2, datë 07.06.2016, të Ministrit të Drejtësisë “Për anonimizimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore që publikohen në portalin elektronik të gjykatave”, Udhëzimit Nr. 15 datë 23.12.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”, si dhe të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, për shkak se ende nuk është ngritur një strukturë e cila do të angazhohet specifikisht me këtë proces pune, por operojmë rast pas rasti.

Megjithatë, pavarësisht kësaj sfide, Gjykata, nëpërmjet koordinatorit për të drejtën e informimit ka synuar të realizojë, për aq sa ka qenë e mundur, respektimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale në vendimet gjyqësore që kërkohen, si një e drejtë themelore në respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, e sanksionuar në Kushtetutë dhe në një sërë aktesh të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.

Gjithashtu është mundësuar edhe afishimi fizik në mjediset e gjykatës i materialeve të përgatitura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, me qëllim informimin e Publikut në lidhje me funksionimin e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm si dhe zyrat e shërbimit, dërguar sipas udhëzimeve të Këshilli i Lartë Gjyqësor, në kuadër të zbatimit të “Hartës së Re Gjyqësore”.

Gjatë vitit 2024, në drejtim të rritjes së transparencës dhe aksesit në drejtësi, ka vijuar ofrimi i shërbimit nëpërmjet pajisjes “ Infopoint” të vendosur në hollin e gjykatës. Nëpërmjet pajisjes “Infopoint” publiku, avokatët, përfaqësuesit ose palët kanë mundësi të marrin informacion në kohë reale nga faqja zyrtare e internetit të gjykatës ose sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve në gjykatë në çdo kohë pa patur nevojë të pyesin apo të presin në radhë te zyra e informacionit.

Bashkëpunimi me publikun dhe median është trajtuar me përparësi nga gjykata duke i dhënë rëndësinë e duhur për të vënë në dukje jo vetëm punën e kryer të institucionit, por duke u parë si mundësi për të na ndihmuar për të evidentuar mangësitë, si dhe për të ndryshuar qasjen e publikut me gjyqësorin, gjyqtarëve me median, pakësimin e problematikave dhe rritjen e besueshmërisë së publikut ndaj gjyqësorit.

Në raport me median gjykata ka treguar bashkëpunim të vazhdueshëm, i cili rezulton se ka qenë në nivelin e duhur, duke komunikuar sipas rastit në lidhje me informacione apo seanca gjyqësore për të cilat publiku ka patur interes. Një risi e kësaj gjykate është krijimi i një grupi në aplikacionin “Whatsapp”, nëpërmjet numrit të telefonit zyrtar, në shërbim të komunikimit me median dhe publikun, me qëllim përcjelljen e njoftimeve në kohë reale për vendimmarrjet e gjykatës për çështjet me interes publik.

Në këto raste media apo gazetarët personalisht janë informuar me anë të njoftimeve elektronike, grupit të “Whatsapp”, si dhe në raste të tjera të veçanta më kërkesë të tyre është mundësuar prezenca në seancat gjyqësore publike duke mbajtur shënime apo dhe pamje filmike. Komunikimi ka qenë interaktiv, i përditshëm dhe në kohë reale. Informacioni i nevojshëm i është dhënë gazetarëve edhe në formë të shkruar në rastet kur kërkimi i tyre është parashtruar me shkrim, në formatin elektronik, duke përdorur email-in zyrtar të institucionit. Gjithashtu sa herë është kërkuar nga gazetarët janë dhënë edhe intervista nga Kancelari i Gjykatës dhe nga Gjyqtari i Medias.

Në Rubrikën “Njoftime për Mediat”, në faqen zyrtare të gjykatës janë publikuar njoftimet për vendimmarrjet e gjykatës për çështjet me interes publik.

Rezulton se është kryer një punë e mirë edhe për informimin dhe sensibilizimin e avokatëve, palëve ndërgjyqëse dhe qytetarëve për marrjen e informacionit mbi shortin dhe planifikimet e seancave gjyqësore nëpërmjet faqes elektronike zyrtare të gjykatës në internet.

Bashkëpunimi me gjyqtarin për media ka qenë i vazhdueshëm, duke kontribuar në mënyrë cilësore në trajtimin e kërkesave për informim.

Në mënyrë të rregullt dhe me mjaft efikasitet komunikimi i brendshëm kryhet në kohë reale, kjo falë përdorimit dhe funksionimit të e-mail-it zyrtar, nëpërmjet të cilit zyra e personelit bashkëvepron me administratën (gjyqtarë + administratë) dhe çdo informacion përcillet në kohë reale duke lehtësuar komunikimin, pakësuar kostot për kancelari (letër, bojë, etj.). Zyra e informimit të publikut është angazhuar që çdo vendim/urdhër t'i komunikohet sipas rëndësisë trupës gjyqësore, administratës dhe të afishohet në faqen zyrtare web të institucionit.

Tashmë përdorimi i aplikacionit elektronik social i dedikuar komunikimeve zyrtare (WhatsApp), për njoftimet e shpejta e sidomos ato në grup, për vetë ritmin e punës që kërkon gjykata, nuk është më një risi, por është kthyer në një domosdoshmëri për administratën dhe trupën gjyqësore.

Gjatë vitit 2024 GJAJP ka qenë prezente edhe në rrjetet sociale dhe ka mundësuar mirëmbajtjen dhe plotësimin me informacion të profilit zyrtar të gjykatës në rrjetin social Facebook e LinkedIn. Në këto profile janë publikuar materialet e përgatitura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, me qëllim informimin e publikut në lidhje me funksionimin e GJAJP dhe Zyrave Shërbimit, në kuadër të zbatimit të “Hartës së Re Gjyqësore”.

Gjithashtu edhe marrje dhe dhënie informacioni nëpërmjet adresës zyrtare sherbime@gjykata.gov.al, ka ndihmuar shumë në shërbimin ndaj qytetarëve, avokatëve, institucioneve shtetërore etj.

Me vendimin nr.18, datë 17.06.2021 të Këshillit të Gjykatës të Apelit Tiranë është miratuar propozimi i gjyqtarit të medias për një gjykatë të hapur për të gjithë, duke bërë të mundur që e premtja e fundit e çdo muaji, të jetë një ditë e hapur për publikun, që dëshiron të vizitojë Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Nga ana e qytetarëve, universiteteve, shkollave, ka patur interes dhe kanë vizituar Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

ÇËSHTJET E INFRASTRUKTURËS, RUAJTJES DHE SIGURISË NË GJYKATË

Nga ana e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, gjatë ushtrimit të detyrës, janë hasur një sërë problematikash, të cilat kanë ndikuar në mbarëvajtjen e punës në këtë institucion. Problematika kryesore në çështjet e infrastrukturës qëndron te godina në të cilën ushtron aktivitetin kjo gjykatë, një godinë e me strukturë të vjetër e të papërshtatur për ofrimin e një shërbimi të tillës si gjykatë. Vështirësitë në ushtrimin me dinjitet të detyrës përqendrohen në mungesën e ambienteve të shërbimit ndaj publikut duke respektuar edhe personat me aftësi ndryshe si dhe sigurinë e përgjithshme të publikut, mungesën e sallave të gjyqit të përshtatura me kërkesat e solemnitetit dhe detyrimeve për ofrimin e seancave gjyqësore publike pasi hapësirat janë të vogla e të limitura, raportit të pamjaftueshëm të sallave përkundrejt numrit të gjyqtarëve, ambienteve të pamjaftueshme për zyra për gjyqtarët dhe personelit administrativ etj. Deri në vitin 2022 kjo godinë ka shërbyer për Gjykatën e Apelit të Tiranës, e cila deri më datën 31.01.2022 ka pasur organikën në total 112 persona, ndërsa në fakt aktivitetin e ushtronin 85 persona. Ndërsa struktura aktuale e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, miratuar me vendimin nr. 555, datë 29.12.2022, përbëhet në total nga 245 punonjës.

Aktualisht në godinë ftuesit, punonjësit e sigurisë dhe sanitaret nuk kanë ambiente ku të qëndrojnë. Ndihmësit ligjorë punojnë në kushte jo normale, ku në një sallë punojnë 10 ndihmës ligjorë, ndërsa në dy zyra të tjera nga 6 ndihmës. Pjesa tjetër e tyre punojnë në ambiente të përshtatura për ta që nuk ofrojnë kushte komode pune. Dhe sekretarët gjyqësorë janë të detyruara të rrinë ngushtë, në ambiente të përshtatura për to. Po kështu nuk ka ambiente për magazinën. Fotokopjet dhe mjete të tjera pune qëndrojnë në korridoret e institucionit.

Zyrat e gjyqtarëve janë të vogla, një pjesë e sipërfaqes së zyrës e zënë dosjet gjyqësore, dhe pa paradhoma të përshtatshme pasi gjykata nuk ka një ambient të përshtatshëm për arkivin aktiv të saj. Gjykata është detyruar që një pjesë të dosjeve t'i magazinon pranë zyrave të shërbimit nëpër rrethe, pasi ka qenë e pamundur mbajtja e tyre në ambientet e gjykatës.

Gjykata nuk ka ashensorë, gjë që bën të vështirë shpërndarjen e dosjeve nga kryesekretaria te gjyqtarët dhe te arkivi.

Për garantimin e rregullit të sigurisë në Gjykatë i jemi drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor për të na mundësuar një fond për instalimin e një skaneri në pjesën hyrëse

ku futen palët në proces, për identifikimin e sendeve të paligjshme, kërkesë e miratuar për vitin 2025.

Për marrjen e masave organizative për alokim fondesh për investim për plotësimin e nevojave për rikonstrukcion të dhomës të serverit i jemi drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, por ende nuk na është miratuar fondi i kërkuar.




ANALIZA E REALIZIMIT TË FONDEVE BUXHETORE

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 743, datë 28.12.2023, “Për detajimin e buxhetit vjetor, viti 2024, për Sistemin Gjyqësor”, miratoi detajimin e buxhetit vjetor për vitin 2024, për sistemin gjyqësor, në nivel artikulli, projekti dhe njësie shpenzuese, ku përfshihet dhe buxheti për GJAJP.

Buxheti i miratuar për këtë gjykatë në fillim të vitit buxhetor 2024 është në shumën 521.300 mijë lekë, ndërsa në fund të vitit 2024 me shtesat dhe pakësimet e miratuara gjatë vitit 2024 është në shumën 509.239,200 mijë lekë i ndarë në nivel artikulli dhe projekti si më poshtë:

Pasqyra e fondeve buxhetore të detajuara për vitin 2024

Emërtimi	Fonde buxhetore 2023	Fonde buxhetore viti fundviti 2024	Diferenca në %
Shpenzime paga (600)	384.018	347.800	-10,4%
Shp. Sig.shoq.&shënd. (601)	36.100	42.000	14.0477%
<i>Shpenzime personeli</i>	<i>420.118</i>	<i>389.800</i>	<i>-7.78%</i>
Shp. për mallra & shërb. (602)	72.776,066	78.510	7.3%
Shp. Transf. Fam. & ind. (606)	316.33	499.2	36.63%
Shpenzime Korrente	493.210,039	468.809,2	-5.2 /%
Shpenzime Kapitale (230)			
Shpenzime Kapitale (231)	5.060	40.430	87.48%
Shpenzime Kapitale	5.060	40.430	87.48%
Totali	498.270,396	509.239,2	2.15%



Buxheti i miratuar për vitin 2024, krahasuar me vitin 2023, është më i lartë në vlerë 10.968 mijë lekë ose në masën 2.15%.

Artikulli 600, shpenzime paga, është pakësuar në shumën 55,000 mijë lekë me vendimin nr. 761, datë 27.12.2024, “Mbi ndryshimin (pakësim dhe shtesa) e buxhetit në sistemin gjyqësor, për vitin buxhetor 2024”. të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Artikulli 601, shpenzime sigurime, është shtuar në shumën 3,000 mijë lekë.

Artikulli 602, shpenzime për mallra dhe shërbime, është shtuar në shumën 48.510 mijë lekë me vendimin nr. 761, datë 27.12.2024, “Mbi ndryshimin (pakësim dhe shtesa) e buxhetit në sistemin gjyqësor, për vitin buxhetor 2024”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Artikulli 606, shpenzime për transf. buxh. familjare & ind., është shtuar në shumën 499.2 mijë lekë për dhënie ndihme në rast fatkeqësie dhe në zbatim të VKM-së nr. 846, datë 26.12.2024 “Për dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare për punonjësit mbështetës të qeverisjes qendrore” si dhe ndihmë ekonomike për rast dalje në pension.

Artikulli 231, shpenzime kapitale (investime), është pakësuar në shumën 3.070 mijë nga Ministria e Financës si dhe vendimin nr. 761, datë 27.12.2024, “Mbi ndryshimin (pakësim dhe shtesa) e buxhetit në sistemin gjyqësor, për vitin buxhetor 2024”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Realizimi për vitin 2024 është në shumën 495.748,071 mijë lekë ose në masën 97.35% e buxhetit të rishikuar.

Fondet buxhetore të gjykatës, të rishikuara së bashku më realizmin e tyre 12-mujor, sipas grup shpenzimeve paraqiten në pasqyrën e mëposhtme:

në 000 lekë

Nr	Emërtimi	Buxheti miratuar për vitin 2024	i Ndryshime gjatë vitit 2024	Buxheti rishikuar për vitin 2024	Realizimi për vitin 2024 në vlerë	Realizimi për vitin 2024 në %
01	Shpenzime paga	402.800	-55,000	347.800	344.763,41	99%
02	Shpenzime sig. shoqërore	45.000	-3,000	42,000	41.745,23	99%
03	Shpenzime për mallra dhe shërbime	30.000	48.510	78.510	78.378,768	100%
04	Shpenzime trans. Fam.	0	499.2	499.2	499.2	100%
05	Shpenzime kapitale	43.500	-3.070	40.430	30.361,461	75.1%
Totali		521.300	-12.060,8	509.239,2	495.748,07	97%

Në nivel artikulli realizmi për gjykatën paraqitet si më poshtë:

Artikulli 600 (paga) – Në këtë artikull, për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është detajuar fondi në shumën 402.800.000 lekë, ndërsa realizimi për vitin 2024, është në shumën 344.763.412 lekë ose në masën 99% e buxhetit vjetor. Përveç pagave mujore të vitit 2024, me këtë fond janë likuiduar edhe të gjitha diferencat e lindura nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese për pagat e magistratëve, paga neto dhe të gjitha detyrimet e lindura për sigurimet shoqërore, shëndetësore, sigurimin suplementar dhe tatimin mbi të ardhurat për të gjitha gjykatat e apeleve të cilat e mbyllën aktivitetin e tyre më 31.01.2023.

Artikulli 601 (Sig. Shoqërore) – Në këtë artikull, për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është detajuar fondi në shumën 42,000 mijë lekë, ndërsa realizimi është 41.745.230 lekë ose në masën 99% e buxhetit vjetor.

Artikulli 602 (Mallra dhe shërbime të tjera) - Në këtë artikull, për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është detajuar fondi në shumën 78.510.000 lekë mijë lekë. Realizimi për vitin 2024 është në shumën 78.378.768 lekë ose në masën 100%. Fondi ka shërbyer për plotësimin e nevojave të stafit me materiale e shërbime zyre, kancelari, shtypshkrime, shpenzime për udhëtim e dieta etj. Janë kryer likuidimet e shërbimeve ndaj të tretëve për drita, ujë, posta, energji elektrike, shpenzime transporti, shpenzime mirëmbajtje të zakonshme, dhe shpenzime të tjera speciale, si pagesa ekspert psikolog e avokat, tatim taksa si dhe ekzekutim vendime gjyqësore.

Tabela e detajuar për artikullin 602, e ndarë në nënartikuj:

Art	Emërtimi	Shpenz. në fakt (lekë)	Pesha në % që zë secili nënartikull
602	Mallra dhe shërb. tjera	78,378,768	100.00%
6020	Materiale e shërbime zyre	9,674,267	12.34%
6020100.2	Letër dhe Kancelari	2,712,492	3.46%
6020200.1	Materiale Pastrimi	416,940	0.53%
6020200.4	Karburant për kaldajë	801,826	1.02%
6020400	Tonera (shërbim printimi)	3,192,509	4.07%
6020500	Shtypshkrime	852,500	1.09%
6020900	Materiale të vogla rutine	342,000	0.44%
6021001	Veshje uniforma	1,356,000	1.73%
6022	Shërbime	13,003,112	16.59%
6022001	Energji Elektrike	4,864,964	6.21%
6022002	Ujë	600,431	0.77%
6022003.3	Telefoni celularë	12,500	0.02%
6022004	Posta dhe Shërbimi Korrier	7,525,217	9.60%

6023	Shpenzime transporti	2,197,826	2.80%
6023100.1	Karburant për automjet	1,070,386	1.37%
6023300	Siguracione	225,000	0.29%
6023900.2	Shpenzime larje makine	88,000	0.11%
6025600	Mirëmbajtje Mjeteve të Transportit	814,440	1.04%
6024	Shpenzime udhëtimi	1,269,544	1.62%
6024100.1	Dieta administrative	753,390	0.96%
6024200	Dieta administrative jashtë shtetit	516,154	0.66%
6025	Shpenz. mirëmbajtje të zakonshme	509,560	0.65%
6021002	Mirëmbajtje lulishte	118,800	0.15%
6025300	Mirëmbajta godine	68,000	0.09%
6025400	Mirëmbajtje pajisje kondicioneri	152,760	0.19%
6025400.1	Mirëmbajtje pajisje kaldaje	170,000	0.22%
6029	Shpenzime të tjera operative	51,724,459	65.99%
6027400	Ekzekutime Vendimi	43,227,922	55.15%
6029002	Shpenz. për Aktivitete Sociale	30,000	0.04%
6029005.1	Shpenz. Pagesë eksperti	888,800	1.13%
6029005.2	Shpenz. Pagesë psikologu	647,010	0.83%
6029005.3	Shpenz. Pagesë Avokati	5,774,000	7.37%
6029005.5	Shpenz. përkthime	609,097	0.78%
6029005.6	Pagesë komisioni për tenderat	232,646	0.30%
6029008	Shpenz. Tatim & taksa	314,984	0.40%

Artikulli 606 (Trans. për Buxh. Fam. & Indivud) - Fondi i detajuar në fillim të vitit në këtë artikull për GJAJP ishte në shumën o lekë. Buxheti i rishikuar vjetor për vitin

2024, si rezultat i shtesave të fondit në këtë artikull është 499.200 lekë, dhe realizimi faktik është 499.200 lekë ose në masën 100% e buxhetit të rishikuar vjetor.

Në total për grupin buxhetor realizimi në shpenzime korrente për periudhën në fjalë (fondi i detajuar) është në shumën 468.809.200 lekë dhe realizimi 465.386.610 lekë është në masën 99.26%. Artikulli 230 - 231 (Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm) - Fondi i programuar për shpenzime kapitale për GJAJP është vetëm me financim të brendshëm, në shumën 40.430.000 lekë nga të cilat: Artikulli 231 - (kapitale të trupëzuara) është detajuar fondi në shumën 40.430.000 lekë, ndërsa realizimi gjatë vitin 2024 është në shumën 30.361.461 lekë ose i shprehur në % realizimi është 75.10 % të detajuar si më poshtë:

Përkatësisht në artikullin 231, për nënartikullin “Rikonstruksion i pjesshëm” është zhvilluar procedura për “ Rikonstruksionin e godinës, ambienteve, rrjetit elektrik, rrjetit kompjuterik, rrjetit të detektimit të zjarrit”. Procedurë kjo e fituar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë SYNAPSE ATS shpk dhe ATOM shpk në vlerën 25.357.944 lekë me TVSH. Po për këtë procedurë janë zhvilluar dhe 2 procedurat për kolaudimin dhe supervizimin e punimeve, përkatësisht kontrata e supervizimit në vlerën 576.717 lekë me TVSH me operatorin ekonomik, Tower shpk; dhe kontrata e kolaudimit në vlerën 75.000 lekë me operatorin ekonomik SIRE-Alb shpk.

Gjithashtu në nënartikullin “Blerje pajisje mobilje” janë zhvilluar 2 procedura. “Blerje rafte metalike arkivore të lëvizshëm dhe statikë për nevojat e institucionit” fituar nga operatori ekonomik ZDRAVA 07 shpk me vlerën 9.989.280 lekë me TVSH. Pas përfundimit të furnizimit dhe vendosjes së rafteve në ambientet e arkivit të gjykatës, u konstatua që këto rafte nuk ishin sipas kërkesave dhe specifikimeve teknike të kërkuar nga autoriteti kontraktor. Sa më sipër, këto rafte nuk u morën në dorëzim nga komisionet përkatës dhe fatura për to nuk u likuidua. Kjo është dhe arsyeja e mosrealizimit në këtë artikull.

“Blerje pajisje zyre, mobilje, tavolina, poltrona, dollape, kondicionerë etj.” fituar nga operatori ekonomik ERZENI shpk me vlerën 4.351.800 lekë me TVSH.

OBJEKTIVA

Objektiva

Analiza vjetore e punës në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2024, i shërben stafit të gjykatës, si dhe aktorëve të tjerë që kontribuojnë në dhënien e drejtësisë, për të përcaktuar qartë objektivat për vitet në vijim, për përmirësimin e cilësisë së dhënies së drejtësisë.

Synimi i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është padyshim ulja e numrit të çështjeve të prapambetura nëpërmjet rritjes së eficiencës dhe efikasitetit në dhënien e drejtësisë, si dhe përmirësimi i standardeve, duke u orientuar drejt një gjykate me një performancë të lartë.

Objektivat e institucionit tonë për vitet në vijim janë:

- Përfundimi i procesit të inventarizimit të çështjeve gjyqësore;
- Përfundimi i kategorizimit të çështjeve në grupçështje prioritare;
- Shqyrtimi i të gjitha çështjeve të kategorizuara prioritare dhe shqyrtimi me përparësi i tyre edhe në vitet në vijim duke kontribuar jo vetëm në uljen e backlog-ut por edhe në parandalimin e krijimit të tij;
- Hartimi i planeve të veprimit (civile dhe penale) për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura për vitin 2025 e në vijim;
- Rritja e Normës së Likuidimit të Çështjeve në 100 % për vitin 2025 dhe tejkalimi i këtij standardi në vitet në vijim me qëllim uljen e backlog-ut;
- Dixhitalizimi e disa proceseve administrative duke pilotuar edhe krijimin e dosjes elektronike;
- Bërja funksionale e ambienteve shtesë me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të punës;
- Krijimi i arkivit aktiv me qëllim lirim të ambienteve të zyrave nga dosjet gjyqësore në pritje për gjykim, administrimin e tij model
- Përpunimi i dosjeve gjyqësore për ruajtje të përhershme/përkohshme dhe asgjësim për arkivin pasiv të gjykatës me qëllim krijimin e hapësirave të reja për arkivim;

- Rritja e komunikimi me aktorët e tjerë, si Dhomën Kombëtare të Avokatisë, Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Realizimi i takimeve periodike me ta, duke analizuar dhe evidentuar problematikat që shqetësojnë gjykatën;
- Monitorimin e vazhdueshëm të marrëveshjes me Posta Sh.a në lidhje me rritjen e cilësisë dhe shpejtësisë në lidhje me shërbimin e dokumentacionit gjyqësor;
- Trajnim i duhur për sekretarinë gjyqësore në drejtim të përmirësimit të aftësive kompjuterike, etikës së komunikimit me publikun dhe zbatimit të ndryshimeve të reja ligjore, si dhe tematika të tjera që do të dalin gjatë vitit;
- Për garantimin e rregullit të sigurisë në Gjykatë është imediate instalimi i një skaneri në pjesën hyrëse ku futen palët në proces, për identifikimin e sendeve të paligjshme.
- Për marrjen e masave organizative për alokim fondesh për investim për plotësimin e nevojave për rikonstrukcion të dhomës të serverit.

PËRFUNDIME

Angazhimi i trupës gjyqësore, nëpunësve civilë gjyqësorë dhe strukturave të tjera administrative e mbështetëse të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka sjellë tregues dukshëm pozitivë të performancës së veprimtarisë gjyqësore dhe asaj administrative e mbështetëse.

Megjithatë, kjo Gjykatë ende nuk ka mundur të parandalojë rritjen e numrit të çështjeve të prapambetura, tashmë të grumbulluara ndër vite.

Vijimi i angazhimit maksimal të gjyqtarëve, ndihmësve ligjorë, sekretarëve gjyqësore dhe administratës tjetër mbështetëse është dhe do të mbetet i pamjaftueshëm për të ulur numrin e çështjeve në pritje për tu shqyrtuar prej vitesh.

Prandaj, për të krijuar kushtet që jo vetëm të pakësojë numrin e çështjeve të prapambetura, por ta përfundojë me sukses këtë sfidë në një periudhë 4-5 vjeçare për të vijuar me një performancë që do të mundësojë jo vetëm shqyrtimin e të gjitha çështjeve që regjistrohen gjatë vitit, por edhe për ti shqyrtuar ato në një afat sa më të shpejt kohor, është e nevojshme që të vijohet me përmbushjen e masave dhe kushteve që janë identifikuar në këtë analizë.

Së pari, përbën domosdoshmëri dhe do të kontribuojë ndjeshëm rritja sa më shpejt të jetë e mundur e numrit të gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm drejt plotësimit të organikës në 78 gjyqtarë.

Së dyti, përbën domosdoshmëri që Kuvendi të miratojë nismat ligjvënëse të depozituara prej disa muajsh, të cilat do të mundësonin dyfishimin në organikë të ndihmësve ligjorë, nëpërmjet një procedure tjetër, jo të formuar nga Shkolla e Magjistraturës, por nëpërmjet konkurrimit në meritë si nëpunësit e tjerë civile gjyqësore, për të cilët parashikohet edhe një trajtim i veçantë financiar.

Së treti, do të sjellë impakt mjaft pozitiv në rritjen e numrit të çështjeve të gjykuara, pa e cenuar në thelb cilësinë e vendimmarrjes, edhe miratimi nga Kuvendi i nismave të natyrës procedurale për shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Civile dhe në Ligjin nr. 49/2012 që lidhen me rrethin e çështjeve për të cilat nuk lejohet ankim dhe rekurs, si edhe për mënyrën e gjykimit në apel të disa kategorive të caktuara të çështjeve me trupë gjykuese monokratike.

Së katërti, edhe pse funksionoi për një kohë të shkurtër, mbështetja me 6 NUNCP, të angazhuar me mbështetjen e Projektit të Asistencës të SHBA “Ulja e Numrit të Çështjeve të Prapambetura dhe Përmirësimi i Efikasitetit”, ka rezultuar mjaft e

dobishme dhe efektive. Ndaj nevojitet që, nëse krijohen kushtet të mundësohet vijimi i këtij bashkëpunimi.

Së pesti, ndërtesa ku ushtron veprimtarinë Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, nuk mund të plotësojë më nevojat për hapësira pune dhe gjykimi, aq më tepër me rritjen e numrit të gjyqtarëve e për rrjedhojë rritjen e pashmangshme të numrit të ndihmësve ligjorë, sekretarisë gjyqësore etj. Prandaj, tashmë është bërë emergjente që KLGJ në bashkërendimin me ekzekutivin të marrë të gjitha masat për krijimin e një infrastrukturë tjetër të re tërësisht të ngritur nga e para me sipërfaqet e nevojshme për salla gjykimi dhe ambiente pune dhe administrative.

Në përfundim, është vendi që edhe njëherë të evidentohet vlerësimi maksimal dhe i merituar, veçanërisht për trupën gjykuese, por edhe për ata punonjës të strukturave të administratës gjyqësore dhe administratës mbështetëse, të cilët, me angazhimin e tyre, kanë kontribuar në përmirësimin e performancës së kësaj gjykate gjatë vitit 2024.

Së fundi, edhe një herë, riafirmojmë vlerësimin dhe konsideratën më të lartë për Këshillin e Lartë Gjyqësor për mirëkuptimin kundrejt vështirësive dhe problematikave me të cilat përballlet kjo Gjykatë, si edhe për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe ndihmesën e dhënë në tërheqjen e vëmendjes dhe në zgjidhjen e nevojave dhe të problematikave më të cilat jemi përballur gjatë kësaj periudhe të mbushur me sfida të jashtëzakonshme, duke bërë të mundur që kjo gjykatë të gjejë zgjidhje dhe mbështetje në funksion të rritjes së cilësisë dhe efikasitetit në veprimtarinë e saj.

ZËVENDËSKRYETARE

ILIBA BEZATI


Aneks

Të dhënat statistikore për dhunën në familje për vitin 2024

Rritja e rasteve të veprës penale “Dhunës në familje”, lidhet me vazhdueshmërinë e problematikës dhe fenomenit të dhunës në familje. Viktimat e dhunës në familje kërkojnë urdhër mbrojtje dhe ndjekje penale. Në tabelat janë të pasqyruar të dhënat në mënyrë analitike për këtë vepër penale.


Vendbanimet

Vendbanimi	Sasia
Qytet	92
Periferi	64
Fshat	94




Mosha

Moshat	Nr
0-15	2
16-18	3
19-25	14
26-35	39
36-45	71
46-55	74
>55	47




Gjinia

Gjinia	Sasi
Femër	205
Mashkull	45



Statusi Civil

STATUSI CIVIL	Nr
Beqar/e	25
Martuar	96
Divorcuar	86
Bashkëjetesë	31
i/e ve	12



Numri i Fëmijëve

Numri Fëmijëve
Asnjë
1 fëmijë
2 fëmijë
3 fëmijë
+4 fëmijë






Figura 1-Numri i Fëmijeve

Niveli i Arsimit



Statusi i Punësimit


Statusi i Punësimit	Nr
I papunë	67
I punësuar në sektorin publik	46
I punësuar në sektorin privat	79
I vetëpunësuar	43
Studente	6
Nxënëse	2
Pensionist	7



Të dhëna statistikore për kërkesa për urdhër mbrojtje për vitin 2024

Kërkesa për Urdhër Mbrojtje	Nr
Pranuar	187
Hedhur poshtë	52
Pushuar	11


Kërkesa për Urdhër Mbrojtje



Lidhja Familjare me Dhunuesin

Lidhja Familjare me Dhunuesin	Nr
Bashkëshorti/ja	161
Motra	12
Vëllai	22
Fëmija	14
Prindi	7
Të tjerë	34

Lidhja Familjare me Dhunuesin



	Urdhra mbrojtje	Urdhra menjëhershëm mbrojtje	të Gjithsej	Pranim i kërkesës	Pushimi i gjykimit	Rrëzimi i kërkesës	Shkelje e urdhrit të mbrojtjes
Vendime sipas Nenit 10	70	180	250	187	11	52	
Subjekte sipas Nenit 13	70	180	250	187	11	52	

Ligji 9669	Urdhri a mbrojtje	Urdhri të menjëher shëm mbrojtje	Gjiths ej	Prani m i kërke sës	Pushi mi i gjyki mit	Rrëzi mi i kërke sës	Shkelje e urdhrit të mbrojt jes
Neni 10 Pika 1	70	180	250	187	11	52	0
Pika 1.a)	40	144	184	184	0	0	0
Pika 1.b)	27	110	137	137	0	0	0
Pika 1.c)	25	95	120	120	0	0	0
Pika 1.ç)	29	87	116	116	0	0	0
Pika 1.d)	27	90	117	117	0	0	0
Pika 1.dh)	13	44	57	57	0	0	0
Pika 1.e)	13	40	53	53	0	0	0
Pika 1.ë)	9	31	40	40	0	0	0
Pika 1.f)	0	45	45	45	0	0	0
Pika 1.g)	0	1	1	1	0	0	0
Pika 1.i)	0	5	5	5	0	0	0
Pika 1.j)	0	7	7	7	0	0	0
Pika 1.k)	0	12	12	12	0	0	0
Pika 1.ll)	0	11	11	11	0	0	0
Pika 1.m)	1	15	16	16	0	0	0
Pika 1.m/1)	0	1	1	1	0	0	0
Neni 13	70	180	250	187	11	52	0
Pika 1.a)	32	0	32	32	0	0	0
Pika 1.b)	38	0	38	38	0	0	0
Pika 3.a)	0	107	107	107	0	0	0
Pika 3.b)	0	73	73	73	0	0	0

